

KOQVARIJA

Ballina: Argjira Osmanaj-Gjyliqi
& Elsa Osmanaj

**KUSH E SHEH ENDËRR
ALBIN KURTIN**


**ASNJË SHQIPTAR
TË MOS JETË MBI TOKË**

**"HAIRLEZZ",
NJË HISTORI SUKSESI
E SHQIPTARES
ARGJIRA OSMANAJ-GJYLIQI**

**BOTA ËSHTË
LODHUR ME NE**

**KU MBET SARANDA ADEMI,
IMAZHI I FIRMAVE BOTËRORE**

**SA DASHNORË
I KA PASUR
GRUAJA IME**





SHERWOOD
Resorts and Hotels



GREENWOOD
Resorts and Hotels

feel the legend



ANTALYA | TÜRKİYE



SHERWOOD
Gölköy Resort



SHERWOOD
Gölköy Lara



SHERWOOD
Divan Resort



SHERWOOD
Pine Hill



3UE
Türkiye
Seyahat



GREENWOOD
Water Resort



GREENWOOD
Water Resort

sherwoodhotels.com.tr | greenwoodhotels.com.tr

+90 444 86 07

Vozitje me veturë nëpër qiell!

Ditë më parë bëra një shëtitje për të satën herë në Luginën e Valbonës, vend me bukuri të rrallë përrallore e me male të thepisura, sidomos në pjesën ku përfundon rruga e asfaltuar, aty ku edhe ndodhen disa hotele e bujtina, të cilat janë të mbushura, kryesisht, me vizitorë të huaj, të cilët kudo i sheh me bagazh në shpinë, të interesuar të shohin Ujëvarën e Valbonës me ujë kristali, e edhe me të tjerë që ia mësyjnë maleve të thepisura për të shkuar në Theth, e që u duhet, së paku, 8 orë ecje këmbë për të arritur në qendër të Thethit.

Pasi bëra një natë gjumë në bujtinën "Krojet e Rrogamit", në mëngjes ia mësyj liqenit të Fierzës, me qëllim që të zë tragetin që udhëton nëpër liqe nga Fierza në Komon, vend afër Vaut të Dejës, në afërsi të Shkodrës, për të vazhduar tutje për në Velipojë. Por, meqë trageti i mëngjesit ishte nisur gjysmë ore para se unë të gjendesha në Fierzë, e trageti tjetër nisej në orën 13, në vend se të prisja, më lind ideja të marrë rrugën për të parën herë nga Fierza për në Pukë, rrugë e cila do kalojë maleve të larta. Dhe, kur arrita te udhëkryqi ku ndodhej tabela se majtas më duhej ta ktheja veturën për në Pukë, u ndala dhe me vete mendova: do ia vlej të marrë atë rrugë të rrezikshme a jo... Jo larg ndodhej një patrullë policie. Dal nga vetura dhe nisem drejt tyre. Kur afrohem i përshëndes dhe u tregoj se jam i interesuar të shkoj në Pukë. "Rruga është me asfalt. Është e qetë", më thotë njëri nga policët. "Sa kilometra mund të jetë larg Puka?", e pyeta. "140 kilometra", ma ktheu.



I falënderova dhe u largova nga ta. Dhe, pas një mëdyshje të marrë atë rrugë a jo, kureshtja ishte më e fuqishme dhe mora drejtimin për në Pukë.

NGJITJA MALIT DREJT QIELLIT!

Në afërsi ndodhej Hidrocentrali i HERC-it, e që rruga më qonte rreth tij. Kthesë pas kthesë, me një përpjetës të madhe, me shpejtësi 10-15 kilometra në orë e hiq më shumë, pas afro gjysmë ore, arrij të ngjitem në pjesën më të lartë të kodrës, nga shihej Liqeni i Fierzës dhe Hidrocentrali në tërësi.

Vazhdoj tutje rrugën...

Asnjë veturë nuk kalonte.

Dhe, po të kalonte si do të kalonte kur rruga ishte shumë e ngushtë...

Pas nja një orë vozitje takohem me veturën e parë që vinte në drejtim të kundërt me timin.

Gjej pak hapësirë në një kthesë dhe e pres të kalojë. Ma bëri me dorë në shenjë përshëndetje.

Gjatë udhëtimit tutje hasa në një motoçiklist të ndalur. Ma bën me dorë të ndalem.

Pasi ndala veturën, dola dhe e përshëndeta shqip. Ma ktheu "Hello".

Nisi të flasë anglisht, por s'dija unë anglisht. I them time mbese e tim nipi që ndodheshin me mua në veturë ta pyesin se çka donte...

Ata, pasi ndërruan disa fjalë me të, më thonë se i paska mbetur motori pa benzinë. I tregojnë se vetura jonë nuk ecte me benzinë, por me naftë. Por, edhe po të ishte me benzinë, si do ia nxirrnim...

Ai më përshëndet me fjalët "Mersi" dhe ma

bën me dorë që të vazhdoj rrugën...

TABELA E SHUMËPRITUR...

Dhe, pas nja tri orë ecjeje me veturë, hasa në një tabelë të madhe.

"Restoranti Alpin, 3 km".

"Eh, doli kafa!", i them time bijë, time mbese e tim nipi, që ndodheshin në veturë me mua.

Kur arritëm te restoranti, kishte vend për parking. Në parking ndodheshin nja 4-5 motoçikleta me regjistrim të Francës.

Pranë tyre e parkova veturën time.

Pasi u ngjitëm disa shkallëve, oborri i restorantit ishte i rrafshët në maje kodre, prej nga shiheshin male të tjerë, si nga aeroplani.

Aty pimë kafe e pushuam hiq më pak se gjysmë ore.

E, kur e thirra kamerierin që të paguaja, e pyeta:

"A është ende larg Puka?".

"Edhe nja 40 kilometra", ma ktheu.

"Eu, bre, po larg qenka!", i thashë.

Ai, në vend të përgjigjes, vetëm buzëqeshi...

Në Pukë arrita pas 5 orë vozitje.

Gjatë gjithë rrugës, meqë i numëronte im nipi, kemi hasur vetëm në 12 vetura...

Puka ishte një qytezë, ama sheshin e kishte të rregulluar mirë. Ishte qetësi që të flinte në shpirt, meqë nëpër shesh nuk lejohej kalimi me vetura.

Në shesh ishte Bashkia, posta, hoteli, disa restorante...

Por, ajo që më flejti në shpirt, në qendër të sheshit ishte busti i Migjenit, i mësuesit të dikurshëm të Pukës, pranë të cilit bëra një foto për kujtim.

Isa ILAZI

Ku ndodhën trashëgimtarët e mulla Ademit?

Kjo shtëpi, që po e shihni në fotografi, ka mbi 100 vjet qyshkur në oborrin e saj çetnikët i prenë e masakruan 25 anëtarë të familjes së Mulla Ademit, nga Keqekolla e Prishtinës.

Ishte viti 1921 kur çetnikët u turrën drejt fshatrave me shqiptarë që ndodheshin në afërsi të kufirit me Serbinë, duke vrarë e masakruar këdo që hasnin përpara. Së pari në Prapashticë, e pastaj në Keqekollë e Ballaban, e tutje me radhë...

Në vitin 1921 çetnikët serbë depërtojnë në Keqekollë, e njëri që fliste shqip troket në derën e Mulla Ademit dhe i thotë të dilte jashtë, në oborr, që t'i ndërrojnë disa fjalë. Me të dalë hoxha jashtë, xhandarët serbë e rrethojnë...

"Hoxhë, sa anëtarë të familjes i ke, gjithsej?"

"28 anëtarë", i përgjigjet.

"A i ke të gjithë këtu, në shtëpi, apo i ke edhe diku tjetër?"

"Të gjithë janë këtu, veç një nuse me dy fëmijë është në gjini, në familje të saj, momentalisht".

"Eh, sa mirë!", i thotë ai.

Pastaj, Mulla Ademin e lidhin për lisin që ndodhej në oborr, në mënyrë që t'i shihte anëtarët e familjes teksa i nxirrin jashtë një nga një.

Pasi i rreshtojnë fillojnë t'i masakrojnë e në fund secilin e pushkatojnë.

Në fund të asaj masakre Mulla Ademiti ia prenë kokën me sëpatë dhe me kokën e tij fillojnë të luajnë top këmbë në oborrin e tij të madh.

Pastaj, vazhdojnë me masakra edhe në shtëpi të tjera. Dhe, kur largohen nga Keqekolla, ata pak bashkëfshatarë të mbijetuar shkojnë shtëpi më shtëpi për të parë se kush u masakrua e kush mbet gjallë. Ata panë se oborri i Mulla Ademiti ishte i mbushur me gjak e kufoma.

Që t'i varrosnin të gjithë as që kishin mundësi, sepse të mbijetuarit ishin pak me numër.

Në mesin e të mbijetuarve në Keqekollë kishte qenë edhe një hoxhë jo i njohur, i cili hyn në bunar të Mulla Ademiti dhe i urdhëron njerëzit që ndodheshin aty që secilën kufomë t'ia lëshojnë me konop në bunar, në mënyrë që t'i lëshojë mbi sipërfaqe të ujit...

KU MBET NUSJA E RE ME DY FËMIJËT?

Fati deshi, siç thamë më lart, që një nuse e re me dy fëmijë nuk ishte atë ditë në shtëpi dhe i shpëtoi masakrës, e cila tronditi Keqekollën dhe fshatrat përreth, por edhe gjithë trevat tjera me shqiptarë. Ditë më parë, krejt rastësisht, nga im dhëndër, doktor shkence Zijadin Krasniqi, mësova se nusja e re me dy fëmijë e vegjël, atë ditë masakre, kishte ndodhur në familjen e saj në Prishtinë.

Nusja quhej Hanife, me fëmijët: Rizah

(djali), e Nexhmije (vajza).

Nexhmija, kur kishte arritur moshën për martesë, ishte martuar në Grashticë të Prishtinës me Mulla Ukën, hoxhë shumë i respektuar në fshat dhe më gjerë. Nexhmija, faktikisht, ishte gjyshja e bashkëbiseduesit tim, Zijadin Krasniqi. Vlen të thuhet se Rizahu, e, po ashtu, edhe Nexhmija, kishin jetuar mbi 80 vjet. Kanë vdekur para pak vjetësh me një periudhë kohe 4-5 vjet ndërmjet njëri-tjetrit. Të dy, si Rizahu ashtu edhe Nexhmija, kanë lënë pas vete familjet e tyre...

SHTËPISË I DUHET NJË RENOVIM I DOMOSDOSHËM

Atë ditë prilli, kur edhe ishim në oborrin ku u masakrua dikur Mulla Ademi me familje, shtëpia ishte rënduar nga vitet, sepse kanë kaluar mbi 100 vjet nga ajo ditë e kobshme, kur edhe u pushkatuan e masakruan e gjithë familja e Mulla Ademiti nga Keqekolla e Prishtinës.

Në oborr nuk dihej vendi i bunarit, sepse të mbijetuarit, pastaj, kishin hedhur mbi të dhe, që të mbuloheshin kufomat.

Tash, kur shtëpia ishte para rrënimit total të saj, do të ishte mirë të shpallej "shtëpi e mbrojtur nga shteti", meqë ende nuk është rrënuar nga vjetërsia.

E, pamja e saj, bashkëfshatarëve, por edhe kalimtarëve të rastit, do ua përkujtojë se popullit tonë, për të arritur këtu ku është, i është dashur tokën e vet ta lajë me gjak...

Isa ILAZI

Pse po lypmi bela?!

“Gjysh, pse e gënjeve njeriun në telefon se nuk je në shtëpi?!”, e pyet nipi gjyshin. “Ti nuk i di do sende, e kur të rritesh e kupton se duhet të gënjesh, përndryshe...”, ia kthen gjyshi nipit.



Si te ne në Kosovë, e edhe më shumë në Shqipëri, nuk shkon ditë e të mos vritet dikush prej dikujt dhe nuk ka ditë të mos theret ndokush me thikë, ashtu që edhe nuk ka ditë të mos rrahet ndokush me ndokënd.

Andaj, rrahjet në Kosovë e Shqipëri janë si buka e djathi, demek nuk të kënaqë shumë buka po nuk pate djathë...

E mbaj mend xha Ajetin kur isha fëmijë. I kishte shumë djem dhe çdo ditë i sillnin nga një bela në shtëpi.

Kur bënin bela të lehta, kur kishin rrahje, nuk kishte nevojë t'i tregonin fare, sepse nuk i llogariste si gjëra të rënda, kurse kur ndodhnin plagosjet thoshte: “Për hajër koftë!”

“O mixha Jetë”, i thoshin: “Djemtë tu janë plagu. A nite a jo?”

“Për hajër koftë çka koftë!”, përgjigjej ai.

Edhe neve, po na lusin me u pajtua me Serbinë dhe mendoj me vete se çka do të bëjmë, ore burrë, nëse pajtohemi?

Do të shuhet një bela e madhe, një front i luftës e i biznesit. Do të shuhet shumë rrugë zinxhirore të biznesit. Kur është fronti i hapur, blejnë dhe shesin, punon tregtia e zezë, punon shverci e kontrabanda... Krejt këto në emër të patriotizmit, siç thoshte i ndjeri Baftiu, në konferencat e fshatit.

Andaj, çka do të bëjmë kur të arrihet marrëveshja paqësore me Serbinë?

Ende kemi shumë “patriotë” dhe e kanë vështrinë të jetojnë pa luftë!

KUSHA IM FLET VETËM PËR RRAHJE!

Kusha im punon taksist. Besa, kohëve të fundit as që po punon, se e ka kapluar sëmundja. Por, kohën kur ka punuar e ka qar duke u rrahur me taksistë të tjerë.

Qysh tregon edhe vetë, cilido që ia ka prishur rendin, i ka dhënë dajak.

Ja bëra kështu një burri... e rraha një tjetër... ja theva kokën atij... shkuam në polici dhe u thashë kështu e ashtu...

Kështu, pra, i ka shkuar jeta kushës tim, sepse rrahjen e ka ushqim të shpirtit.

Bukën mund ta lë, ama grushtin jo!

E, shqiptari, edhe kur e ngritë dorën për të stopuar ndonjë automjet, posa ta ngritë

dorën ia dhuron një sharje: “Ndale bre, nënën...!”

Dhe, këtë nuk e bëjnë vetëm katundarët, siç thoshim dikur, por edhe të arsimuarit, intelektualët, këngëtarët...

Njëri prej këtyre “intelektualëve”, që po e kursej të mos ia përmendi emrin se e njehë i madh e i vogël, e le telefonin mbi tavolinë dhe vetë hyn në banjë. Ndërkohë, telefoni cingëron. I thotë menaxherit:

“Shih, bre, kush është!”

“Qenka Izeti”, ia kthen menaxheri.

“Uh, bre, ku më gjeti bash tash ai bërllok!

Hape telefonin dhe rreje diçka! Thuaj se jam diku... Kudo qoftë!”, i flet nga banja.

Dhe, pasi menaxheri ia thotë Izetit fjalët e

“intelektualit”, ai e kupton se po e gënjen.

Izeti pyet në sportel të hotelit se në cilën dhomë ndodhet ai, demek “intelektuali”...

Dhe, ia mësynë dhomës... Pasi troket në derë, një njeri e hapë derën.

Izeti i thotë se ishte ai që e kërkoi pak më parë në telefon “intelektualin”...

Burri afrohet te banja dhe i thotë se erdhi ai që të kërkoi pak më parë në telefon.

E, kur “intelektuali” e hapë derën e banjës dhe e sheh Izetin, i bërtet menaxherit:

“Pse nuk më the se ishte Izeti, jarani jem! Mendova se është Izeti i Preshevës e atë nuk e kam në huj hiç, bre mahluk!” dhe i afrohet menaxherit t’ia ngrehë veshin...

Por, ai, siç e kishte zakon të rrejë, rrenën nuk mund ta largonte nga vetja. Një ditë vjen nga Zvicra një mik i tij dhe e thërret në telefon. I thotë se ka ardhur nga Zvicra dhe dëshiron ta takojë...

E, ai i përgjigjet me një qeshje të gjatë...

“Po, mirë që paske ardhur në Kosovë, por unë jam në Tiranë. Besa edhe gruaja nuk është në shtëpi. Ka tri ditë që është në Stamboll. Unë kthehem nesër nga Tirana, kurse gruaja pas një jave dhe shihemi”, i thotë ai.

E, nipi, i cili ndodhej afër gjyshit dhe e kishte dëgjuar bisedën e zhvilluar, i thotë:

“Gjysh, pse e rrejte që nuk je në shtëpi?!”,

“Shuaj! Pasha gjyshin ti s’e di pse duhet me rrejt! Je ende i ri e mendon që nuk duhesh gënjyer, por kur të bëhesh sa gjyshi mësohesh edhe ti”, ia kthen ai.

Mallkuar qofsh, o kurbet!

Zbrita nga treni atëbotë dhe eca një orë e gjysmë deri në shtëpi. Doja të ngihesha frymë të vendlindjes, sepse më kishte munguar ajri sa e sa vjet. Më kishin munguar edhe bari, edhe malet, edhe kodrat...

Te "Bregu i mullirit" ngrita kokën ta gjeja odën e babait, me krenarinë e vet hyjnore, por nuk e pashë nga pullazi i një shtëpie të re, që ishte ndërtuar afër saj.

Mendova se do e shihja posa të afrohesha edhe pak, por kur u afrova pashë një gërmadhë, e që ishte mbuluar me bar e therra...

Nisa t'i urreja të dyja, përnjëherë, pasi e kishin pushtuar odën e vjetër, ku vinin burra nga të gjitha anët e Kosovës...

Ndala hapin dhe mu duk se e shihja babën këmbëkryq, në ballë të odës. Në të djathtë të tij shihja Raif Tashollin, një burrë i gjatë, e që ushtronte zejen e metaleve në bodrumin e shtëpisë.

Mjeshtëria kryesore e tij ishte punimi i pushkëve. Raifi i kishte mbajtur 12 vjet burg në Mitrovicë të Sremit, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, sepse ishte për rrënimin e Jugosllavisë.

BURRI QË I DËGJONTE LAJMET E "RADIO LONDRËS"

Në të majtë të babait shihja Lif Hoxhën, burrin që dëgjonte lajmet e "Radio Londrës", e më tej, nga ai, shihja mikun e shtëpisë, xha Fetahun, babën e të cilit e

kishte vrarë hasmi.

Një grua e kishte marrë hakun e burrit, duke e kryer aktin e vrasjes, veshur me tesha të burrave...

Në anën e djathtë nga oxhaku shihja Hasanin e Malishevës dhe Nekiun e Prizrenit, e që, më vonë kuptova se ai ishte nga Vermica e kufirit me Shqipërinë.

Në odë e pashë edhe patriotin e madh nga Cërnila e Ferizajt, Brahim Graincën, që kishte mbajtur burg për deklarin për bashkim me Shqipërinë, pikë ku edhe ishin ndarë me Fadil Hoxhën, me të cilin kishin qenë bashkëluftëtarë.

Dhe, secilin burrë që shihja, ishte histori në vete...

NË ODËN E BABAIT BËHESHIN DASMAT E MËHALLËS

Bëj ca hapa tutje dhe nën gërmadhë shoh trapazanin e odës (gjasthtë metra i gjatë e tre metra gjerësi, brenda odës 100 metra katrorë).

E, nën trapazan, babai i mbante drurët për stufën e odës...

Sillem tutje dhe dal kah dera e odës, aty ku kanë shkelur pragun mijëra burra e dasmorë.

Dhe, më shfaqen para sysh dasmat e gjithë mëhallës, e që bëheshin aty. Në hajatin e odës bëhej çaji dhe buka e dasmave.

PSE I MËSHONIN SHKELM DERËS SË ODËS NJERËZIT E UDB-së?

Tutje dal te dritarja e madhe prej druri, në të cilën kanë trokitur para mëngjesit shumë herë njerëzit e UDB-së, kur kërkonin të dinin se kush ishte në odë. Babait nuk i pëlqente kur dikush trokiste në dyert e oborrit a në derën e odës. Thoshte se nuk ishte shenjë e mirë që dikush u mëshonte dyerve të oborrit, pa e thirrur emrin e babait në derë...

Dhe, u solla fund e krye odës së vjetër. Mu duk sikur burrat e mëdhenj janë nën gërmadhat e saj. Mu duk sikur fjalët e tyre dhe të bëmat i ruante oda, nëpër kohë... Mu mbushën sytë lot kur m'u kujtuan gjithë ata burra, e që asnjëri prej tyre më nuk është gjallë.

Trarët e një ane të odës ishin me maja në tokë, e bishti u qëndronte akoma në qiell. Vetëm gurët e saj ende nuk kishin lëvizur, sepse trashësia ishte gjysmë metri.

PSE DALLDISËT SHPIRTI?



Natë e vonë vere.
Vapë e madhe, e padurueshme. S'mund as të flesh. Më kot përpëlitesh në krevat herë djath-tas e herë majtas...
Në këto momente mundohesh të gjesh diçka me çka do t'i kalosh këto çaste të neveritshme, qoftë me ndonjë emision televiziv apo me ndonjë libër...
Mbi tavolinë të punës: libra, materiale të ndryshme, fletë me shënime gjithfarë, të pa seleksionuara, të renditura... Marrë ca prej tyre, të cilat i kam shënuar vetëm si skica, pika orientuese për t'i zgjeruar pastaj, herëdokur, në një kohë...
Lexoj dhe i ndaj disa për këtë numër. I rishkruaj ashtu siç i paskam shkruar dikur. Shpresoj se do u pëlqejnë...

*
Njerëzit e pasur nuk kanë kohë shumë, sepse janë të brengosur si ta rrisin pasurinë! Jetojnë me frikën se do të bëhen të varfër. E, të varfrit kanë frikë se nuk do të kenë sukses për të gjallëruar. Jetojnë me shpresën: Zoti e bën mirë!

*
Në një ndejë ode, para shumë vitesh, në fshatin Turuçicë, një plak gjatë fjalës së tij pat thënë: "Katër gjëra është mirë t'i shfrytëzosh gjatë

jetës:
Rininë para pleqërisë;
Pasurinë para varfërisë;
Shëndetin para sëmundjes;
Jetën para vdekjes.

*
Heshtja është më e rëndë se fjala. Si të qëndrohet, si të durohet? Thonë: Heshtja është ar. "Jo", thotë njëri me përvojë të gjatë të jetës. "Heshtja është zjarr që djeg pa e ndier!". Siç do të thoshte poeti i mjerimit, Migjeni: "Më s'besoj në fjalët e kësaj bote!". Njëmend, si të besohet në fjalët e gënjeshtreve dhe gojëndyrëve, në fjalët e botës së marrë?

*
S'ka njeri (ai që ka ndjenjë, shpirt e zemër) që nuk i zgjohet brendësia dhe t'i thotë shpirtit: "Ç'ke sot a sonte që nuk më lë të qetë, je dalldisur o shpirti im?!". Sigurisht, edhe poeti i madh, Khajami, ka qenë në të tillë gjendje shpirtërore, kur shkroi: Natën kur flija, më tha shpirti - Pi! Në gjumë dhe në varr s'ka lumturi! Ngrehu, sa rron zbraz kupa e puth çupa! Ke shekuj që të flesh në qetësi!

Eh, shpirti...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Edona Vllasaliu - Bajoku
Xheneta Spahiu
Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Në ballinë...

“Hairlezz”, një histori sukseesi e shqiptares Argjira Osmanaj - Gjyliqi

“Hairlezz” është rrjeti i qendrave estetike të specializuara në heqjen e përherëshme të qimeve me laser.

“Hairlezz” u themelua në vitin 2021 dhe aktualisht ka pesë filiale: në Zürich, Rümlang, Luzern, St. Gallen, dhe Prishtinë, ku punohet me laserët me tri gjatësi valësh.

Prapa qendrave estetike të trajtimit tejet efikas me laser, “Hairlezz”, qëndron pronarja Argjira Osmanaj - Gjyliqi, bashkë me bashkëshortin e saj dhe me motrën Elsa Osmanaj, duke e udhëhequr bashkërisht këtë biznes të njohur e të suksesshëm në Zvicër, e, së fundi, edhe në Kosovë.

Klientët në “Hairlezz” mund të presin rezultate të shkëlqyera, përfshirë lëkurë të lëmuar dhe pa qime pas vetëm disa seancash.

Gjithashtu, gjithmonë një shërbim profesional dhe diskret. Për historinë e tyre të suksesit dhe çdo gjë që ka të bëjë me “Hairlezz”, flasin për revistën tonë, “Kosovarja”, Argjira Osmanaj-Gjyliqi, pronare, si dhe motra e saj, krahu i djathtë në biznes, Elsa Osmanaj.



■ Ç'THOTË ARGJIRA OSMANAJ - GJYLIQI?



“Gjithçka filloi nga një dashuri e thjeshtë për kujdesin ndaj vetes. Ajo ndjenja kur ndihesh si mbretëreshë në lëkurën tënde... Ky ishte momenti që më ndezi kuriozitetin dhe dëshirën për të eksploruar çdo teknologji të re që mund të përmirësonte këtë ndjenjë”.

Argjirë, pak fjalë për veten?

- Jam një grua me shumë pasion, për bukurinë, për kujdesin personal dhe për të ndihmuar të tjerët të ndihen të mrekullueshëm në lëkurën e tyre. Megjithëse kam studiuar ekonominë (mendja praktike), zemra ime gjithmonë ka qenë në industrinë e bukurisë.

Në fund të fundit, kush thotë se nuk mund të përqendrohesh në financa e bukuri njëkohësisht?

Po, të tjerët si të përshkruajnë?

- Në rrethin e gjerë shoqëror dhe familjar më përshkruajnë si njeri të qetë dhe

shumë të dashur.

Po ashtu, më përshkruajnë si person energjik, të përkushtuar dhe me vullnet të fortë.

Jam, gjithashtu, e njohur për qasjen time pozitive dhe përkushtimin ndaj punës që bëj.

Qe sa vjet je larg Kosovës?

- Qe 33 vjet jam larg Kosovës, ama zemra ime ka qenë dhe do të jetë gjithmonë në Kosovë.

Unë e kam shpirtin në Kosovë, edhe kur jam larg. Këmbët gjithmonë më tërheqin drejt shtëpisë – ndoshta nga ushqimi i mirë, apo nga njerëzit e dashur, kush e di...

Ke studiuar ekonominë, ndërkaq merresh me fushën e bukurisë. Pse?

- Ekonomia më ka dhënë një mendje të mprehtë për menaxhim dhe strategji, por bukuria – ah, ajo është dashuri në shikim të parë!



Unë e pashë potencialin e bukurisë dhe vendosa që është koha të ndjek zemrën dhe të sjell estetikën dhe elegancën në jetën e të gjithëve.

Si nisi rrugëtimi yt në këtë fushë?

- Gjithçka filloi nga një dashuri e thjeshtë për kujdesin ndaj vetes. Ajo ndjenja kur ndihesh si mbretëreshë në lëkurën tënde. Ky ishte momenti që më ndezi kuriozitetin dhe dëshirën për të eksploruar çdo teknologji të re që mund të përmirësonte këtë ndjenjë. Kështu filloi gjithçka...

Na fol për "takimin" e parë me laserin dhe kur u binde që do të jetë puna jote?

- "Takimi" im i parë me laserin ndodhi kur unë vetë kërkova një zgjidhje efektive dhe afatgjatë për heqjen e qimeve. Pasi pashë rezultatet pozitive dhe ndikimin që kjo kishte në vetëbesimin tim, u binda që kjo është një fushë ku mund të kontribuoj dhe të ndihmoj edhe të tjerët.

Kur është hapur pika e parë e "Hairlazz"?

- Pika e parë e "Hairlazz" u hap në vitin 2020 dhe ajo shënoi fillimin e një rrugëtimi të suksesshëm në industrinë e bukurisë dhe estetikës.

Sa qendra të "Hairlazz" i keni tash?

- Sot "Hairlazz" numëron pesë qendra, të cilat janë të shpërndara në lokacione të ndryshme dhe ofrojnë shërbime të avancuara në fushën e kujdesit për lëkurën.

Sa është sfida menaxhimi?

- Menaxhimi është një sfida e vazhdueshme. Imagjino të mbash pesë qendra

dhe të jesh nënë e dy fëmijëve! Por, me një ekip të fortë dhe me një filxhan kafeje, çdo sfidë duket pak më e lehtë. Dhe, kur ke pasion për atë që bën, asgjë nuk është e pamundur...

Pak fjalë për qendrën në Prishtinë dhe nga të erdhi ideja?

- Qendra në Prishtinë është një nga krenaritë tona më të mëdha. Ideja lindi nga dëshira për të sjellë një qendër moderne dhe të avancuar në kryeqytetin tonë, ku klientët mund të përjetojnë shërbime të një standardi ndërkombëtar.

A kujdesen femrat në Kosovë mjaf-tueshëm për veten?

- Femrat në Kosovë janë gjithnjë e më të vetëdijshme për rëndësinë e kujdesit për veten. Ato e dinë që bukuria fillon nga brenda, por nuk dëmton të ndihmojmë pak edhe nga jashtë, apo jo?

A është e vërtetë që laseri i zhduk qimet përgjithmonë dhe nëse po për sa seanca?

- Laseri është një super-hero i qimeve të padëshiruara, meqë redukon qimet në mënyrë dramatike për shumë njerëz dhe rezultatet janë të qëndrueshme. Zakonisht, duhen rreth 6-8 seanca për të arritur një rezultat perfekt, por, si gjithmonë, varet nga lloji i lëkurës dhe qimeve.

Çka ju dallon nga të tjerët?

- Ajo që na bën të veçantë është përkushtimi ynë për cilësi dhe për të thënë gjithmonë të vërtetën.

Nuk ka rrugë të shkurtër në këtë fushë – përdorim teknologjinë më të avancuar dhe kujdesemi që çdo klient të marrë shërbimin që meriton.

Jeta jote private?

- Jeta ime private është plot me dashuri, momente të mrekullueshme me familjen dhe, natyrisht, pak çaste të çmuara për veten. Kam një lidhje të fortë me bashkëshortin tim, fëmijët e mi dhe, pa dyshim, me motrën dhe prindërit e mi. Ata janë bota ime...

Faleminderit i thua...?

- Faleminderit bashkëshortit tim që gjithmonë më ka ndihmuar dhe më ka mbështetur në çdo hap! Jam shumë mirënjohëse për motrën time, që është dora ime e djathtë dhe partnerja ime në çdo sfidë... Një falënderim i madh u takon edhe prindërve të mi, të cilët gjithmonë kanë qenë aty për mua... Dhe, natyrisht, faleminderit mikeshës sime më të mirë, që ka qenë me mua që nga fillimi dhe më ka mbështetur në çdo hap të këtij udhëtimi! Andaj, pa ju, të gjithë, asgjë nga kjo nuk do të ishte e mundur...

Mesazhi juaj?

- Mesazhi im është që çdo njeri të kujdeset për veten dhe të investojë në shëndetin dhe mirëqenien e tij. Vetëbesimi fillon nga mënyra se si ndihesh në lëkurën tënde, e ne jemi këtu për të ndihmuar në këtë drejtim...

■ Ç'THOTË ELSA OSMANAJ?



"Të punoj pranë motrës sime në "Hairlazz" është një përvojë e mrekullueshme. Kemi një lidhje të fortë dhe mirëkuptim të ndërsjellë, gjë që e bën bashkëpunimin tonë shumë të suksesshëm".

Elsë, si e përshkruan veten?

- Jam person që vlerësoj shumë përkushtimin dhe ndershmërinë, qoftë në jetën profesionale, ashtu edhe në atë personale. Me një përvojë të gjatë në fushën e shëndetësisë, kam zhvilluar një ndjeshmëri të veçantë për nevojat e të tjerëve dhe gjithmonë mundohem të jap më të mirën time për të ndihmuar. Jam, gjithashtu, njeri i vendosur dhe i fokusuar, me një qëllim të qartë për të bërë një ndryshim pozitiv në jetën e njerëzve që më rrethojnë...

Keni studiuar e punuar infermiere. Sa të përbushë kjo punë?

- Puna infermiere më ka përbushur në mënyrë të jashtëzakonshme, sepse më jep mundësinë t'i ndihmoj njerëzit në momentet më të vështira të jetës së tyre. Ndjenja e të qenit aty për të tjerët dhe të ndihmuarit në përmirësimin e shëndetit të tyre më sjell kënaqësi pa masë. Përveç kësaj, kjo punë më ka mësuar shumë për durimin, empatinë dhe rëndësinë e bashkëpunimit.

Si është të jesh gjithmonë në shërbim të shëndetit të të tjerëve?

- Të jesh gjithmonë në shërbim të shëndetit të të tjerëve është një përgjegjësi e madhe dhe nderë e veçantë.



Është punë që kërkon shumë përkushtim, por shpërblimi shpirtëror që merr kur sheh dikë të përmirësohet falë ndihmës suaj është i papërshkrueshëm.

Kjo është një thirrje që kërkon një zemër të madhe dhe një mendje të përgatitur për të përballuar sfidat që vijnë çdo ditë...

Jeta në Diasporë - sfidë apo mundësi avancimi?

- Jeta në Diasporë është, pa dyshim, një sfidë, por edhe një mundësi e madhe për avancim.

Sfidat vijnë nga largësia me familjen dhe nga përballja me një kulturë të re, por këto sfida na forcojnë dhe na mësojnë të jemi më të adoptuar dhe të hapur ndaj ndryshimeve.

Nga ana tjetër, Diaspora ofron mundësi të shumta për rritje personale dhe profesionale, duke krijuar rrugë të reja për zhvillim dhe sukses...

Si është të punosh pranë motrës tënde në "Hairlazz"?

- Të punoj pranë motrës sime në "Hairlazz" është një përvojë e mrekullueshme. Kemi një lidhje të fortë dhe mirëkuptim të ndërsjellë, gjë që e bën bashkëpunimin tonë shumë të suksesshëm.

Kemi mundësinë t'i kombinojmë forcat tona dhe të ofrojmë shërbime cilësore për klientët tanë.

Është kënaqësi të punosh me dikë që ndan të njëjtën pasion dhe vizion për punën...

Marrëdhënia jote me laserin?

- Marrëdhënia ime me laserin është shumë profesionale dhe e bazuar në një kuptim të thellë të teknologjisë dhe përfitimeve të saj.

Laseri është një mjet i fuqishëm në industrinë e bukurisë dhe mjekësisë dhe unë jam gjithmonë e përkushtuar të jem në hap

me zhvillimet më të fundit në këtë fushë për të ofruar shërbime të sigurta dhe efektive për klientët tanë.

Pse duhet që njerëzit t'i bëjnë trajtimet me laser në "Hairlazz"?

- Njerëzit duhet ta zgjedhin sallonin "Hairlazz" për trajtimet me laser, sepse ne ofrojmë shërbime me standarde të larta, duke përdorur teknologjinë më të avancuar dhe me një ekip të kualifikuar profesionistësh.

Ne i trajtojmë klientët me përkujdesjen maksimale, duke u siguruar që çdo trajtim të jetë i personalizuar dhe i sigurt.

"Hairlazz" është i përkushtuar ndaj rezultateve të shkëlqyera dhe të kënaqësisë së klientit dhe kjo na bën të dallojmë nga të tjerët.

Përtej punës, cila është jeta jote private?

- Përtej punës jeta ime private është e përkushtuar ndaj familjes dhe vetëzhvillimit.

Më pëlqen të kaloj kohë me të dashurit e mi dhe të eksploroj aktivitete që më ndihmojnë të relaksohem dhe të përmirësoj veten, si: leximi, ushtrimet fizike dhe udhëtimet.

Besoj se balanca ndërmjet punës dhe jetës private është thelbësore për një jetë të shëndetshme dhe të lumtur.

Mesazhi juaj?

- Mesazhi im për të gjithë është që të mos ndalojnë kurrë së ndjekuri pasionet e tyre dhe të kujdesen për shëndetin e tyre, si atë fizik ashtu edhe atë mendor. Jeta është dhuratë dhe është e rëndësishme ta jetojmë atë me dashuri, përkushtim dhe mirësi ndaj vetes dhe të tjerëve. Kujdesuni për veten dhe mos harroni të kërkonti ndihmë kur ju nevojitet për shëndetin dhe mirëqenien tuaj!

Nderim Neziri

Asnjë shqiptar të mos jetë mbi tokë!

Vaso Çubriloviqi ishte një nga akademikët dhe studiuesit serbë që janë marrë, kryesisht, me studime dhe memorandume për zhdukjen e shqiptarëve, rrugë të cilën e ndoqi edhe nobelisti Ivo Andriqi, pastaj Dobrica Qosiqi e edhe Akademia e Shkencave dhe Shoqata e Shkrimtarëve të Serbisë!

Akademiku Vaso Çubriloviqi:

"Ne, serbët, nuk kemi armiq më të mëdhenj se shqiptarët.

Nëse duhet të ngremë kokën tonë, duhet të ulim kokën e tyre.

Nëse duhet të ndjehemi gjërë në territore, duhet të ngushtojmë hapësirat e tyre.

Nëse duhet të na dojë bota, duhet të bëjmë që bota t'i urrejë ata.

Që shqiptarët të braktisin vendin e tyre, duhet me çdo kusht dhe me çdo mënyrë t'u nxijmë jetën.

Të arrijmë deri këtu, së pari, duhet t'u mohojmë origjinën ilire epirote dardane dhe t'u vrasim krenarinë ilire, t'u shkatërojmë vatrat dhe t'u ngatërrojmë emrat, t'u njollosim emblemat dhe t'u fshijmë simbolet e lashta ilire.

Duhet, domosdoshmërisht, t'i bëjmë që të bjerrin gjuhën dhe zakonet e tyre, njëkohësisht t'u rrëmbejmë gjithçka që kanë të lashtë ilire.

T'i lëmë pa miq rreth e rrotull, derisa ata të urrejnë dhe mos durojnë njëri-tjetrin e

përfundimisht të mohojnë vetveten. E, që të finalizohet kjo platformë, duhet domosdoshmërisht që antishqiptarizmi të jetë filozofia dhe deviza e vetme e shtetit tonë.

Mos harroni: Mosqenia e shqiptarëve është vetë ekzistenca e kombit serb! Të gjitha epitafet në varrezat shqiptare të shkruhen në gjuhën arabe dhe simboli Yll e Hënë të mbisundojë!"

P. S.

Kur një akademik shkruan kështu, çka pritet prej të tjerëve?!

Ikja e shqiptarëve nga Toplica në vitet 1877-1878

 **SENATOR**
HOTEL



/hotelsentortirane

Rruga Fortuzi 47, Tirana, Albania, 1001
Tel: +355 67 422 2444; Email: info@hotelsentor-al.com

Të mos i harrojmë:

Akademik Gazmend Zajmi

Ideatori i Kosovës Republikë

Akademik Gazmend Zajmi u lind në rrethin e Krumës së Hasit, në Shqipërinë verilindore.

Shkollimin e bëri në Prizren. Studio drejtësi dhe shkenca politike në Universitetin e Beogradit, ku kreu magjistraturën në vitin 1973.

Pas studimeve punoi gjyqtar në Prizren dhe ligjëroi në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Prishtinës.

Në kohën e demonstratave të vitit 1981 ishte rektor i Universitetit të Prishtinës dhe për 10 vjet u dëbua prej tij nga autoritetet serbe.

Akademik Gazmend Zajmi ishte anëtar i Komitetit të Përhershëm të Konferencës së Rektorëve Evropianë, i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve (në Salzburg dhe Vjenë). Punoi profesor i "Teorisë politike" dhe i të "Drejtës kushtuese" në Universitetin e Prishtinës.

Ishte shef i Katedrës së Shkencave Shoqërore-Politike dhe i shumë funksioneve të tjera.

Por, si kryetar i Akademisë së Shken-

cave dhe Arteve të Kosovës, kishte arritur të hartonte Deklaratën Kushtuese për shpalljen e "Kosovës Republikë", pas suprimimit të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, deklaratë të cilën unanimisht e përkrahën dhe e shpallën Kosovën Republikë delegatët e atëhershëm shqiptarë të Kuvendit të Kosovës, më 2 korrik 1990, e që ditë më parë qe përvjetori 34. Vdiq më 10 mars 1995.

tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin

www.touristcamping.me

Tel: +38269336233

 /giovanniscampingresort



Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin

www.touristcamping.me

Tel: +38269825858

 /giovannis_beach_montenegro

Nga notesi i gazetarit: Për herë të parë në Turqi

Hasan Gashi u bë Hasan Hakubeti!

Me tim mik, Qazim Ibrahimin, me të cilin punoja në “Rilindje”, në qershor të vitit 1990 udhëtonim me veturën e tij për në Stamboll.

Dhe, teksa e kaluam Bullgarinë dhe iu nënshtruam kontrollit kufitar të Turqisë, një polic turk m'u drejtua turqisht. Unë, meqë nuk e kuptoja, vetëm rrudha krahët...

Qaza, i cili tashmë nuk është në mesin e të gjallëve, e dinte deri diku turqishten, sepse shpesh udhëtonte për në Stamboll. Më thotë:
“Polici po thotë a po e merrni një shok të tij në veturë për në Stamboll. A e marrim?”

“Merre, pse jo!”, i them.

Dhe, pas këtyre pak fjalëve, në ulësen pas nesh ulet doganieri, i cili do udhëtonte me ne për në Stamboll nja 5-6 orë udhëtim... Gjatë rrugës, shkaku i monotonisë, Qaza tregonte ndonjë mahi, e që më bënte të qeshja.

Por, pashmangshëm ishte të mos flisnim edhe për politikë, sepse në atë kohë veç sa nuk nga kishin larguar nga Pallati i Shtypit, meqë masat represive serbe sa vinin e shtoheshin.

Dhe, teksa bisedonim, herë seriozisht e herë tregonim ndonjë mahi, në një semafor, një shofer me regjistrim turk e kishte bllokuar komunikacionin dhe nuk mund të kalonim udhëkryqin.

“He, nënën...”, më dolën këto fjalë nga goja, më shumë pa dashje.

Qaza me zë të ulët më thotë:

“Mos hy andej se e kemi këtë prapa!”

“Jo obo, ky nuk merr vesh!”, i them.

Dhe, pa kaluar disa sekonda, polici që ishte ulur në ulëset e fundit, tha:

“Krejt u kam marrë vesh çka kenë fol, se edhe unë jam shqiptar”.

“Po, a, po pse nuk po tregon, bre burrë?!”, i them.

“Nuk deshta me u prish muhabetin!”, ma ktheu.

“Nga i ke pas familjen? Nga cili vend?”, i

them.

“Nga Prishtina. Unë jam i lindur në Turki”.

“Ku jeton tash?”

“Me gru e thmi jam në Istanbul, e babën e kam në Bafra”.

“Sa është Bafra larg nga Stambolli?”, i them.

“1000 kilometra. Asht ngat Kara Denizit (Detit të Zi), karshi Rusisë”.

“A ka shqiptarë në Bafër”.

“Po. Ka shumë. Shqiptarë ka edhe në Samsun, ni shehër afër Bafres”.

Dhe, teksa i kalojmë nja dy orë bashkë rrugë nga momenti kur polici tregoi se ishte shqiptar, e pyes, kryesisht, pse kanë shkuar mu atje, si jetojnë atje...

SI IA MËSYNA BAFRËS?

Atë natë flemë në një hotel afër Kapadi Çarshisë (Çarshia me ari) në Stamboll. Të nesërmen Qaza kishte për të blerë gjëra për butikun e tij.

Por, ditën e dytë, teksa shëtisnim nëpër Stamboll, hasëm në një stacion të autobusëve.

I them Qazës të hyjmë në stacion dhe të pyesim a ka autobus që shkon për në Bafër.

“Pse?”, më thotë.

“Ti ktheu në Prishtinë se unë do të shkoj

në Bafër. Kam dëshirë të takohem me familjen e Ajdinit, doganierit që e kishim me vete në veturë nga kufiri i Turqisë e deri në Stamboll. Autobusi nga Stambolli për në Bafër nisej në mbrëmje në orën 18. E rezervoj aty për aty biletën dhe i them Qazës të kthehem në hotel e ta marrë valixhen, se kisha edhe ti orë kohë deri në nisjen e autobusit...

HEJ, KU E DI SE JAM SHQIPTAR?!

Në mbrëmje, në orën 18 zura vend në autobusin që shkonte nga Stambolli për në Bafër.

Udhëtuam tërë natën, me dy-tre pushime në restorantet pranë rrugës, sa për të pirë kafe.

Në mëngjes, shoferi i autobusit bëri një orë pushim në një restorant, për ta "qel" pak fytyrë me naj kifile e çaj...

Por, siç tha shoferi i autobusit, pas pyetjes që i bëra, kanë mbetur edhe nja 4 orë për të arritur në Bafër, e që rruga në ato çaste kalonte nëpër Anadoll, vend i shkret, me katunde të rralla e shtëpi qerpiçësh, krahinë e banuar kryesisht me arnautë (shqiptarë).

Në një fshat të Anadollit, të cilin rruga e drejtë e ndante në dy pjesë, për herë të parë dhe të vetme në jetë pashë një njeri teksa lëvronte tokën me parmendë, të cilën e tërhiqte gomari...

Dhe, pas 17 orësh rrugë të gjatë e të mundimshme nga lodhja, arritëm në qytetin buzë Detit të Zi, në Bafër.

Në stacionin e autobusëve, i cili ndodhej në qendër të Bafrës, pasi dola nga autobusi, vendi i parë që dëshiroja ishte të gjeja një hotel, ku do të pushoja e flija, sepse kisha përshtypjen se sytë më ishin ajur pa gjumë tërë natën.

Përballë stacionit sytë më shkuan në një objekt, që në fakt ishte bujtinë.

"Eh, e gjeta!", thashë.

Dhe, u nisa drejt tij...

Kur iu afrova afër, në shkallët e tij qëndron-te ulur nën hijen e bujtinës një njeri.

I afrohem afër. E shikoj në sy...

"A është hotel?", i thashë shqip.

Ai, në vend të përgjigjes, vetëm më shikoi dhe hodhi shikimin në drejtim tjetër.

"A punon ti këtu?", i them, po ashtu, shqip, pas pak.

"Ku e di se jam shqiptar!", ma ktheu shqip.

"Surratin e ke të shqiptarit!", i them.

"E ti, kush je?", më thotë.

"Jam nga Kosova. Ke ni naj herë për Kosovën?", i thashë.

"Po, e di ku asht Kosova. Gjyshi jem ka ardh nga Vuçiterna", më thotë. Dhe, fjalë pas fjale, i tregoj qëllimin pse ndodhesha në Bafër...

"Jo, nuk ka hotel për ty. Do të vish në shpinë teme, do të pushosh, e në mbrëmje të qoj në ni katund ngat, atje asht ni plak 80 vjet, ka lind në Prishtinë", më thotë.

"Ah, fort mirë. Kam qef me e taku atë plak", i them.

Dhe, nisemi për në veturën e tij. Kthesë pas kthesë, në periferi të Bafrës, e ndalë veturën pranë një shtëpie.

"Shpia jeme asht", më thotë.

Derën e oborrit e hapë një grua e re.

Kemali i tregon se jam jabanxhi nga Kosova...

Dhe, teksa i ndërrojme disa fjalë, gruaja e tij sjell kafet turke.

Pas nja një orë muhabet, e ku biseduam për shumëçka, Kemali më tregoi se punon në postë, se nga Kosova vijnë letra për arnautët, që, siç thotë ai, jemi këtu, se nxënësit në Turqi shkollohen vetëm në gjuhën turke, se nuk ka libra e as revista arnautçe...

Dhe, pas një pushimi 2 orë, drekën gruaja e Kemalit e kishte bërë gati.

E, pas dreke Kemali më thotë të shkojmë në katundin afër, aty ku edhe më tha më parë se ndodhet plaku që është i lindur në Prishtinë...

Pasi e lëshuam Bafrën, në tabelën e një fshati shkruante "Jakimtash".

Kemali e lëshon rrugën kryesore dhe merr rrugicën majtas që shkonte në thellësi të fshatit.

Pas pak, më thotë:

"Ajo atje (bën me dorë në drejtim të një shtëpie të vogël buzë malit). Ajo asht shpia e Hasanit, plakut nga Prishtina.

Kur arritëm te dera e oborrit, fikë veturën.

Troket në derën e oborrit, të cilën pas pak

na e hapë një vajzë, e cila na përshëndet me "Akshamllar!".

Kemali i tregon se unë jam jabanxhi nga Kosova dhe dëshiroj të takohem me plakun Hasan.

Na fton të hymë në oborr, e pastaj na drejton drejt shtëpisë.

Në gjyzzentinë e shtëpisë përdhese, këmbëkryq pinte duhan plaku, Hasani, të cilin edhe e kisha objekt të kësaj vizite...

Dhe, kur Kemali i tha se jam nga Prishtina, edhe një herë më mori ngryk dhe më tha: "Zoti koftë me ty!".

"Jam le në Mramor, ngat Prishtinës. Babës i ke ba menja veç Turki..."

Prej Prishtinës kemi ardh me pampur të xhave deri në Stamoll. Kemi kalu nëpër Shkup e Selanik.

Dimnin e parë e kemi kalu në Stamoll.

Në pranverë baba më tha i blejmë dy ki e ni kerr dhe lypim ven tjetër, se nuk i pëlqente Stamolli.

Ishte pranverë kur jemi nis... 6 muj i kemi kalu në udhë: ditën ecshim, natën flejshim në kerr.

Pas 6 muj, kur kemi ardh në ket ven ku jemi tash, baba, tha: "Ma nuk lypim ven tjetër. Po nalmi këtu se po ma qon mallin e Mramorit".

N'atë kohë isha 13 vjet. Mas ni kohe baba më mori me vete në kerr të kive dhe shkum në Bafër, në hyqmet.

Ata të hyqmetit na i lypën dokumentat e Serbisë dhe kur ua dhamë, më thanë:

"Ti emnin Hasan, a?".

"Po", u thashë.

"Ngallapin Gashi, a?".

"Po, Gashi", i thashë.

"Këtu Gash nuk ka, por duhet me e gjet ni ngallap tjetër. E thu ti ose të ngjesim na, thanë".

E, kur na thanë se Gash nuk mund të shkruhem, u thashë: "Leni jul".

Na regjistruan po atë ditë. Ma nuk isha Hasan Gashi po Hasan Hakubet!".

Në atë kohë nuk na u duk i keq ngallapi, por ma vonë, kur e mësuam pak turqishten, e pamë se kishin ba hajgare me neve...

Tash jemi tu u munu me e kthye apat Gashi, por po na lypin shumë dokumenta me i ba gati...

LARGIMI NGA BAFRA

Familjen e doganierit Ajdin nuk mund e gjeta, edhe pse i pyeta të gjithë ata me të cilët jam njohur gjatë tri netëve sa i kalova në familjen e plakut Hasan Gashi, nga Mramori.

E, pas tri netësh te Hasan Gashi, ia mësyj Samsunit, pastaj Ankarasë, Brusës, Ada Pazarit dhe në fund arrij në Stamboll.

Por, të gjitha përjetimet me shqiptarët e këtyre qyteteve nuk mund të përfshihen në një shkrim, as edhe në disa shkrime, por nevojitet një fejtun i gjatë, madje.

Isa ILAZI



Moderatorja e personaliteteve politike...

Kush e sheh ëndërr Albin Kurtin?



Miranda Shala

Moderatorja e njohur, Miranda Shala, me emisionin e saj televiziv "Sante", ka arritur t'i ketë mysafirë pothuajse fytyrat më të njohura politike, ku nga secili bashkëbisedues arrin të nxjerrë në pah periudha të ndryshme të jetës sonë politike dhe jo vetëm politike. Ajo ka arritur t'i ketë mysafirë deputetë më të zëshme të Parlamentit të Kosovës: Doarsa Kicën-Xhelilin, deputete e LDK-së, pastaj Ariana Musliun, deputete e PDK-së. Por, edhe politikanët: Ramush Haradinajn, Sami Lushtakun dhe Arben Gashin: i pari kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës,

i dyti ish-kryetar i komunës së Skenderajt, ndërkaq i treti deputet dhe kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së.

Bashkëbisedues i Mirandës në emisionin e saj televiziv ka qenë edhe Adem Grabovci, ish-deputet i Kuvendit të Kosovës dhe njëri nga iniciatorët e pajtimit të gjaqeve në Kosovë, pastaj ish-deputeti Fisnik Ismajli, gazetarja Zana Avdiu, e kështu me radhë...

Së fundi, mysafir i saj në emision ishte deputeti nga radhët e VV-së, Mefail Bajqinovci, të cilit i bëri pyetjen interesante: "A e sheh ëndërr Albin Kurtin?"

Rrëfim intim

A do të mbetëm gjithmonë dashnore e burrit që i ka 4 fëmijë?

E dua dhe më dashuron, por e di se e do edhe gruan e tij, me të cilën i ka 4 fëmijë. Gruaja e tij, edhe pse e di se jam në lidhje me burrin e saj, e, mbase, edhe do të lindja edhe fëmijën e tij, më ndihmon sa herë që kam nevojë të shkojë te mjeku...

E vetmja gjë që më mundon është pyetja se çfarë do të bëhet me jetën time, si dhe a do të mbetëm gjithmonë dashnorja e tij...

Ishim duke festuar pesë-vjetorin e njohjes sonë dhe po kalonim çaste shumë të bukura bashkë, kur unë papritmas ndjeva një lëvizje në bark dhe menjëherë u shtanga.

I tregova për këtë të dashurit tim, por ai nuk i kushtoi rëndësi kësaj pune. Ndërkaq, mua më shkoi mendja menjëherë se kisha mbetur shtatzënë, edhe pse nuk dëshiroja të mendoja për një gjë të tillë.

Atë natë as që kam vënë gjumë në sy. Mendja më shkonte gjithkund... Ngan-



jëherë mendoja në ndonjë gjë të bukur, por realiteti në të cilin ndodhesha m'í prishte të gjitha...

Shpresoja të mos ishte kjo që po mendoja dhe të nesërmen me shumë frikë shkova te gjinekologu. Ai menjëherë më tha se isha shtatzënë dhe atë, madje, në muajin e tretë.

Dhe, kur m'í tha këto fjalë e di se mu morën mendtë dhe më nuk di si ka rrjedhur ngjarja...

MË MBYSTE NDJENJA QË MBAJA NË BARK NJË FËMIJË JASHTËMARTESOR!

Pasi më kaloi ajo kllapi, u këndella pak dhe bisedova me mjekun. I tregova se nuk ishte e mundur të isha shtatzënë, meqë ciklet mujore i kam pasur me rregull çdo muaj dhe nuk kisha vërejtur se po më fryhej barku.

Edhe ndonjëherë kur më dukej barku paksa i fryrë, mendoja se kisha filluar të trashesha apo kisha ngrënë më shumë se që ishte nevoja.

Dhe, që nga ajo ditë, ndjenja që mbaja në bark një fëmijë të pafajshëm më mbyste, por edhe më dhimbsej fëmija, i cili do të lindte jashtë një

martese të rregullt.

Pas pak ditësh në zyrën time erdhi gruaja e të dashurit tim, së bashku me vajzën e vogël të saj. Nuk dija çfarë t'í thosha në atë moment kur ajo pa barkun tim paksa të fryrë. Dhe, kur e vërejti barkun tim, thellë ofshani...

GRUAN E DASHNORIT TIM E BËRA MIKE!

Një natë, derisa po flija, ndjeva një dhembje, e cila ma nxori gjumin. Vëreja se kisha gjakderdhje, e që dhembja sa vinte më shtoej.

Nuk dija çka të bëja... Pas pak vendosa ta thërrisja të dashurin tim në telefon. Në telefon u lajmërua gruaja e tij. Në çast u stepa. Në mendje mu soll shumëçka...

Por, pasi i shpjegova pse kisha thirr në atë kohë, për çudi, ajo u tregua shumë gjakftohtë dhe më tha se menjëherë do vijnë bashkë me burrin e saj që t'më ndihmojnë...

Pas pak ata erdhën dhe më dërguan në spital. Atje m'u desh të abortoja, meqë fëmija nuk ishte shtuar me peshë...

Ishte momente të vështira për mua...

Vetëm qaja... Mendtë donin t'më dilnin nga koka... Kërkoja të vdisja në ato çaste...

Por, më vonë vendosa të përmbahesha dhe kam dëshirë të mos i ndodhë asnjë vajze ajo që më ndodhi mua...

Pasi më lëshuan nga spitali kisha nevojë të largohesha nga ai ambient ku ndodhesha. Doja të ikja nga realiteti, të cilin e kisha përjetuar.

Shkova në Velipojë dhe atje u vendosa në një banesë, me qëllim që të shëtisja bregut të detit dhe të lirohesha sado pak nga ajo që kisha përjetuar. Atje qëndrova dy javë. Dhe, dhembja ime u qetësua pak, por jo aq sa të ndihesha mirë si para asaj që më ndodhi...

Megjithatë, nuk dëshiroja më t'ia ndieja as zërin të dashurit tim, e lëre më ta shihja...

Për çudi, mu largua shumë nga zemra...

Pas një kohe e takova atë. Ishte bashkë me gruan e tij. Sapo më pa la gruan dhe vrapoi pas meje.

Por, unë isha e prerë: nuk doja ta takoja më... Sepse, zemra nuk mund të ndahet në dy pjesë. Ajo vetëm si e vetme mund të funksionojë si duhet...

V. Ejupi

Në cilin fshat në Kosovë ndodhen arkat e mbretit me ari?

Para një dekade është shtruar asfalti ku lugina “Klysyрка” ka shpalosur bukuritë mahnitëse. Sepse, para asaj kohe kishte rreziqe për kalimtarët. Por, pse flitet se arkat me ari janë në kodrinën e Gadimes së Lipjanit?

Para se të shtrohej asfalti rrugor Lipjan-Gjilan, lugina “Klysyрка” ruante jo vetëm bukuritë mahnitëse, por edhe rreziqet për kalimtarët. Ajo nis me të mbaruar Gadimja e Epërme dhe përfundon me të hyrë në fshatrat e Gjilanit: Kishnapolë, Sllakoc, Zhegoc e Gadish. Historiku thotë se emri i fshatit më të madh në Kosovë, Gadime, rrjedh nga fjala ilire Gradina, që shtrihet rrëzë maleve mbi Gadimen e Epërme. Aty ishte derdhur gjak nga luftërat iliro-romake, sipas legjendave të shumta. Rrallë ndodh të gjesh një mitologji aq të pasur me ngjarje të dukshme dhe të padukshme që përbëjnë një histori të tërë gjërash që ka mundur t’i ruajë deri në ditët e sotme vetëm lugina “Klysyрка”, përgjatë së cilës rrjedh lumi po me këtë emër.

KUSH HIDHTE GURË MBI MULLINJ?

Qamil Tasholli, më i vjetri në këtë anë, në kohën kur bëmë bisedë me të, thotë se për ta deshifruar luginën, duhet të lidhemi me gojëdhënat.

Lugina është nja dhjetë kilometra gjatësi, e që ruan ende arkat e paçelura të miteve. Për këtë, Qamili thotë:

“Dikur në Gadime shitnin dru malësorët, duke ardhur nga bjeshka në rrafsh. Atëherë bjeshkët kanë qenë me drunj të gjatë, e jo si sot, që pak ngjasojnë në bjeshkë. Kah kishin ardhur me kuaj e qerre me dru për në rrafsh, u kishin dalë qoftëlargët dhe

ua kishin ndalur qerret. Herë-herë edhe ua kishin rrotulluar...

Kjo thuhet se ka ndodhur në qindra raste, sepse sa e sa herë kanë treguar pleqtë për këso ngjarjesh...

Për me dëshmuar se ka pasur diçka të tillë, përgjatë luginës ka pasur edhe mullinj, ku kanë bluar misër, grurë e bungur, njerëzit e kësaj ane.

Dhe, disa nga mullinjtë i mbaj mend edhe vetë...

Pleqtë dikur tregonin se natën hidheshin gurë mbi kulmet e mullinjve.

E, kush i hidhte nuk shihej...

Te “Kroni i Akullit”, në ahishtë, edhe sot hasim njerëz që marrin ujë. Dikur në këtë vend zanat e malit shiheshin natën si bukuroshe të pakrahasueshme. Hidhnin valle dhe këndonin bukur”.

KODRA QË RUAN ARKAT E THESARIT TË MBRETIT

Se ka ndodhur një dyndje iliro-romake në Gradinë, flet edhe historia. Kisha edhe sot i ka themelet, duke qenë e rrethuar me oborr dhjetëra hektarësh e me lule jargavani, ku njerëzit i marrin për bimë dekorative.

Rreth këtyre ngjarjeve, bashkëbiseduesi ynë, thotë:

“Me të filluar lugina, është kodra rrumbullake si plis, në krye të së cilës, thonë, mbreti e kishte mbretërinë.

E shihni kodrën me formë plisi?

Thonë se deri te ngjitja në maje të saj kishte

shkallë, ku bartej malli. Thuhet se ajo kishte tunele dhe dyer. Brenda tuneleve thuhet se ka arka me ari.

Një kushëri imi, deri vonë e ka pasur një hartë të kësaj kodre me rrethinë, ku evidencoheshin me shenja vendet dhe lokacionet e pasura.

Kush e ka bërë atë hartë nuk e di, por harta ka qenë, e pronari i saj ku e ka marrë nuk e di e as nuk ka treguar kurrë. Ai sot nuk është në jetë, e kujt ia ka lënë hartën nuk e di.

Në atë kodrinë rrumbullake me formë plisi, thuhet prej pleqve, por edhe me hartën që e përmendëm, një mbret ka lënë aty arka me ari.

KA NDRYSHUAR GJITHÇKA...

Para se rruga të ndërtohej dhe të shtrohej asfalti që është tash, nuk ka qenë lehtë ta kalosh luginën, sepse terreni malor ka qenë i keq.

Kur binte shi e borë, lumi tërbohej dhe kalimi bëhej tepër i zorshëm...

Tash, me ndërtimin e rrugës së re, kalimi nëpër këtë rajon është bërë i kalueshëm dhe atraktiv për kalimtarët dhe vizitorët, të cilët e shohin si është tash, por nuk dinë se çka flitet për këtë rajon dhe çka ka në brendi të tokës...

Dhe, teksa ndahem nga bashkëbiseduesi, mendja më rri te arkat me ari. A thua, vërtet, ka arka me ari në luginë apo janë fjalë të cilat janë përcjellë brez pas brezi?

S. K.

ENJOY EXCLUSIVE PRICES

END OF SUMMER SALE



MARINA BAY RESORT & CASINO

Rr. "Aleksandër Moisiu", Vlorë, Albania | +355 69 604 1000 | info@marinabay.al



Si t'i largoj njerëzit toksikë? Është një ndër pyetjet më të shpeshta që më shtrohet nga klientela dhe, të them të drejtën, ende nuk kam gjetur përgjigjen adekuate, madje as edhe për veten time.

Është egoja personale me atë profesionale që si këshilltare thur një përgjigje si reflekto dhe mëso të dallosh për kë ia vlen një shpjegim, për kë një përgjigje dhe për kë nuk ia vlen asgjë!

Por, ku është etika njerëzore këtu?

Të pëshpërit ndërgjegjja pasi të gjithë ata njerëz toksikë shumë herë i ke edhe në rrethin më të ngushtë familjar dhe nuk e ke fatin si në rrjetet sociale t'i bllokosh ose edhe t'i shlyesh!

Një kundërragument të vjen shpejt në mendje dhe ta arsyeton të tërën se zhvlerësimi i njerëzve toksikë dhe eliminimi

Njerëzit toksikë kanë nevojë për dashuri, por mbi të gjitha për kufij!

i tyre nga jeta jote do të thotë të kesh respekt për mirëqenien tënde!

E mirë kjo sikur të ishte e vërtetë dhe ta besonim, mirëpo në qoftë se bëhemi plotësisht të sinqertë me veten tonë, cili nga ne është edukuar me normën se në qoftë se një person i "dashur" na dëmton në vazhdimësi, duhet ta lëmë apo të largohemi nga vetërespekti dhe vetëmbrojtja.

ÇFARË ËSHTË NJË PERSON TOKSIK?

"Toksik" do të thotë "helmues". Një person bëhet toksik kur ai ose ajo ka një ndikim negativ në mjedisin ku jeton dhe në mënyrë të dukshme (me paramendim) dëmton njerëzit që i rrethojnë ata.

Në praninë e tyre na bëjnë të ndihemi keq, të pavlerë dhe inferiorë që shpesh çon në dhunë psikologjike dhe abuzim emocional.

Për psikologjinë tonë një sjellje që kalon kufijtë njerëzor, pa marrë parasysh në çfarë relacioni jemi me persona të tillë, klasifikohet, gjithashtu, si e rrezikshme dhe e dëmshme për të ecur në jetë. Një sjellje që na irriton, manipulon, na grabitë energjinë dhe gëzimin e jetës, na ulë vetëbesimin dhe vetëvlerësimin dhe krijon drama dhe probleme aty ku nuk ka, mos prit të fillojë me "dajak".

Ky abuzim psikologjik dhe emocional, madje, nuk njih as moshë, as status, as gjini.

Këtu kemi të drejta të barabarta, bile thuhet se burrat abuzohen më shumë se

gratë verbalist, por që krenaria e tepërt që kanë i "shpëton" ata!

THËNIE TIPIKE TË NJERËZVE TOKSIKË!

Për të manipuluar mjedisin ku jetojnë dhe njerëzit që i rrethojnë, siç përmenda më lart, njerëzit toksikë nuk përdorin dhunë fizike, por këta persona me këtë çrregullim të personalitetit toksik shpesh përdorin fjali dhe thënie, si:

Kur do m'u mbush mend?

Me mend të fëmijëve gjithmonë, krejt i ngjave babës tënd!

Kryet e ngritë si nëna jote!

Mos me kanë unë as qentë nuk të hanë!

Ti kurrë s'ke me arritur diçka në qoftë se nuk ndryshon!

Unë për të mirën tënde e kam!

Çka kam bërë unë për ty e tash po më lë!

Kurrë s'ke ditur për vete, krejt je tranu!

Ti nuk je normal, shumë ngatë zemre po i merr të gjitha!

Me kanë i kënaqur që po të rrijë, veç unë t'kam majtë se kush nuk do me ndenjtur me ty!

Ti definitivisht je bërë për psikolog, etj. Pra, është një listë e gjatë vreri e mllëfi e një dhimbjeje shpirtërore, por ashtu, si-kurse edhe lista e shkaqeve të një sjelljeje toksike që rrënjë i ka të lëshuara thellë në fëmijërinë tonë të hershme.

Janë traumat tona të mbyllura me dry nga mungesa e dashurisë së atyre që as vetë nuk morën gati kurrë dashuri siç duhet.

E, një uri e pangopur për vëmendje, që kompensohet në këtë mënyrë, mund të shërohet vetëm me dashuri dhe mirëkuptim për njëri-tjetrin.

Megjithatë, toksiciteti nuk njihet si një çrregullim psikologjik në psikologji, falë Zotit, sepse atëherë të gjithë nuk do të ishim normal, edhe pse unë personalisht kam përvojën se marrëdhëniet toksike mund të jenë edhe dhurata më e mirë për të lëvizur nga zona e komoditetit.

Atëherë kur je e helmuar, por prapë di të falësh; atëherë kur në kërkim të kundërhelmit ke filluar të nuhatësh harmoninë dhe dashurinë për tjetrin, ashtu siç Zoti e krijoi; atëherë kur shërimi yt shpirtëror veç ka filluar.

Shkendije Pacolli



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkendije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges

BOOM



**Ku mbet
Saranda Ademi,
imazhi i firmave
botërore?**

**Cilët janë
VIP-at kosovarë
jashtë politikës?**

Billie Eilish
vuan nga një
sindromë e veçantë,
ka miliona ndjekës
dhe arriti majat e top-listave

Billie Eilish vuan nga një sindromë e veçantë, ka miliona ndjekës dhe arriti majat e top-listave

Ka shumë gjëra të jashtëzakonshme në lidhje me artisten Billie Eilish. Këngëtarja dhe autorja e këngëve të talentuara, tashmë ka edhe rifillimin e një vetëeraneje muzikore me përvojë.

Debutimi i saj muzikor në vitin 2017, me këngën "Don't Smile", arriti ta rendiste të 20-ën në top-listën kryesore të SHBA-së dhe në mbarë botën. Në vitin 2019, albumi i saj i parë debutues, u rendit i pari në Top 20" në Billboard, duke i dhënë një sukses të jashtëzakonshëm një artisteje. Ajo përfundimisht ka gjetur zhanrin që i përshtatet, e që është të kënduarit në rrymat e zbehta që lidhin hendekun midis indit eterik elektronik dhe popit të errët alternativ.

ADOLESHENTJA ME MILIONA NDJEKËS NË "INSTAGRAM"

Billie Eilish është adoleshentja e parë, e ndjekur nga miliona ndjekës në rrjetin social "Instagram".

Me vargje angulloreshe, introspektive, që nuk guxojnë të largohen nga çështjet e shëndetit mendor, ajo u përpoq me një audiencë të përkushtuar gjatë viteve të saj të përparimit në fund të

viteve 2010, kur ajo ishte vetëm një adoleshente.

Më poshtë janë disa fakte interesante për këngëtarën që ka obsesionuar botën:

*Arritjet e saj muzikore nuk janë vetëm mahnitëse, ato janë të pashembullt.

*Rinia e Eilish merr vëmendje të madhe. Ndërsa rinisja e saj muzikore është mbresëlënëse për këdo të çdo moshe,

është diçka krejtësisht e re: ajo është artistja e parë dhe akoma e vetmja, e lindur në këtë shekull që ka një hit që u rendit në numrin 1 në tabelën amerikane Billboard.

*Ajo vjen nga një familje e njohur në industrinë e argëtimit

*Eilish është vajza e Maggie Baird dhe Patrick O'Connell, të dy emra të njohur në industri në Bregun Perëndimor.

*Vëllai i saj dhe bashkëpunëtori i saj i shpeshhtë, Finneas O'Connell, është muzikant, gjithashtu.

*Ajo mori famë nga platforma Soundcloud.

*Ndërsa jemi në temën e këngës "Ocean Eyes", ajo, së pari, tërhoqi vëmendjen e industrisë së muzikës, pasi e publikoi këtë këngë në Soundcloud në vitin 2016. Edhe pse është e popullarizuar në mesin e artistëve të rinj, është e rrallë që një këngëtar pop të fillojë të bëjë muzikë në atë platformë.

*Një fakt tjetër i mahnitshëm është mosha e saj.

*Pa dyshim, Eilish është e vetmja këngëtare e lindur në vitet 2000 që ka një hit të renditur në vendin e parë në Billboard. Por, po aq mbresëlënëse është fakti se ajo është, gjithashtu, femra më e re që ka një album të renditur në vendin e parë në Mbretërinë e Bashkuar.

FAKTET E MAHNITSHME NUK KANË TË BËJNË VETËM ME MOSHËN E SAJ

Karriera e jashtëzakonshme e Billie Eilish tejkalon moshën dhe gjininë e saj, por ajo mban rekorde për shkak të të dyjave. Kur albumi i saj debutues me gjatësi të plotë "When We Fall Asleep, Where Do We Go?", u publikua në janar të vitit 2019, secila këngë e xhiruar ishte pjesë e listës Top 100 të Billboard. Kjo i dha asaj gjithsej 14 këngë në tabelë, rekordi i parë që një artiste femër ka shënuar ndonjëherë.

Ashtu si shumica e muzikantëve tril-lues, ndikimet e saj janë tepër të larmishme.

Eilish u rrit duke dëgjuar muzikë po aq të larmishme sa: Beatles, Green Day, Avril Lavigne dhe Justin Bieber.

Frymëzimi i saj më i madh, thotë ajo, është hip-hopi, duke cituar artistin Gambino, si personi që pat më së shumti ndikim në shijen e saj muzikore.

Kopertina e albumit të saj është e frymëzuar nga përmbajtja e albumit (tmerret e natës, ëndërrimi i kthjellët etj.)

Nga interesimi i Eilish për filmat horor, filmi australian horor psikologjik

"Babadook", i vitit 2004 ishte një ndikim specifik.

MUZIKA E SAJ ËSHTË AQ E GJERË SA KRITIKËT NË THELB E KANË QUAJTUR GJITHÇKA

Disa muzikantë kanë një pikë të vetme referimi (Greta van Fleet me Zeppelin, për shembull). Të tjerët i përziejnë mirë zhanret, por Eilish duket se e ka goditur një pikë aq të ëmbël krijuese sa muzika e saj i kundërvihet kategorizimit.

Është përshkruar si indie elektronike, EDM, dance-pop, synth-pop, R&B, jazz, pop, avant-pop, art pop dhe më shumë.

AJO VUAN NGA NJË SINDROMË E VEÇANTË

Këngëtarja ka treguar kohë më parë përmes një postimi në "Instagram" se vuan nga Sinroma Tourette, që është një çrregullim neurologjik të ketë inde fizike ose verbale të pavullnetshme.

Në rastin e Eilishit ajo tregon tika fizike, jo verbale. "Unë kurrë nuk e kam përmendur (Sindromën time Tourette) në internet, sepse askush nuk mendon se jam e prekur", shkroi Eilish në InstaStory.

"Si dhe fakti që unë kurrë nuk kam dashur që njerëzit të mendojnë për xhunga sa herë që mendojnë për mua", ka shkruar më tej ajo.

ÇFARË ËSHTË SINDROMA TOURETTE?

Sindroma Tourette (TS ose thjesht Tourette's) është një çrregullim i zakonshëm neuro-zhvillimor me fillim në fëmijëri, i karakterizuar nga tika të shumta motorike dhe të paktën një tik vokal (fonik).

Këto teknika dylli dhe të zbehta mund të shtypen përkohësisht dhe, zakonisht, paraprijnë nga një nxitje ose ndjesi e padëshiruar në muskujt e prekur.


Disa nga tikat e zakonshme janë fryrja e syve, kollitja, pastrimi i fytyrës, nuhatjet dhe lëvizjet e fytyrës.

Tourette nuk ndikon negativisht në inteligjencën ose jetëgjatësinë.

Tourette është përkufizuar si pjesë e një spektri të çrregullimeve tik, e cila përfshin tika të përkohshme, kalimtare dhe të vazhdueshme (kronike).

Tiket janë shpesh pa u vënë re nga vëzhguesit rastësor. Ndërsa, shkaku i saktë është i panjohur, besohet se përfshin një kombinim të faktorëve gjenetikë dhe mjedisor.

Nuk ka teste specifike për diagnostikimin e Tourette; jo gjithmonë identifikohet saktë, sepse shumica e rasteve janë të buta dhe ashpërsia e tikave zvogëlohet për shumicën e fëmijëve pasi kalojnë adoleshencën. Ekstremi Tourette në moshën e rritur, edhe pse i sensibilizuar në media, është një gjë e rrallë.



Ku mbet Saranda Ademi, imazhi i firmave botërore?

Ajo është një super femër, një ish-modele ose e para shqiptare që thyente tabutë atëherë kur askush nuk guxonte në Kosovë...

Sot është një nënë e lumtur, por pa harruar sakrificat e saj, e, mbi të gjitha, krenare që është shqiptare kudo që jeton.

Fjala është për Saranda Ademin, femrën që dikur ishte bashkëpunëtoresha, e revistës sonë "Kosovarja", e që tash jeton në Zvicër.

Pas fatkeqësisë që pat vite më parë, atëherë kur as mjekët me tituj shkencorë nuk besonin në rilindjen e saj, ajo sot është më e fortë se kurrë, me plot vullnet e shembull për mijëra femra të tjera...

Saranda e kujton kohën e tmerrshme të fatkeqësisë, në mars të vitit 2012, që, sipas mjekëve, ajo nuk do mund të dilte nga koma, e as nuk do mund të fliste e të lëvizte...


Por, jetës nuk i dihet...

Ajo iu rikthye jetës dhe në vitin 2019 që zgjedhur model për kompaninë "Dove", e më vonë edhe për kompaninë "Didier Voirol" në Zvicër.

Ajo gjithmonë ka thënë në intervistat e saj se nuk do të jetë vetëm modele për imazhin e bukurisë natyrale, por edhe motivim për njerëzit. Ajo thotë se është më se e lumtur që si shqiptaro-zvicerane është imazh i kompanisë së lartpërmendur dhe se suksesin ua dedikon vajzave të saj me emrat Lea dhe Lira.

"Motoja ime ka qenë dhe mbetet: Po qe se dëshironi të tërhiqni vëmendjen e të tjerëve, nisuni dhe tërhiqni veten, duke u kujdesur për trupin tuaj në maksimum!", pat thënë kohë më parë Saranda.

Shtrohet pyetja: Ku ndodhet Saranda sot dhe ç'punë bën?



Cilët janë VIP-at kosovarë jashtë politikës?

VIP (Very Important Person) apo "Person shumë i rëndësishëm" konsiderohet ai person, i cili gëzon privilegje speciale që statusin e tij e bëjnë të dallueshëm apo të rëndësishëm brenda shoqërisë. Andaj, kush e gëzon këtë status në Kosovë jashtë politikës?

Privilegjet e shumta, veturat luksoze dhe numri i madh i truprojave, janë vetëm disa prej elementeve që disa nga politikanët e Kosovës i bëjnë që të trajtohen si VIP-a, një epitet ky që kudo në botë u jepet personave, të cilët, brenda shoqërisë ku jetojnë e veprojnë, gëzojnë statusin e të privilegjuarve.

Ndërkaq, në Kosovë e kanë shumë më vështirë të trajtohen si figura të tilla njerëzit që vijnë nga fushat e tjera, siç janë

muzika, kultura, sporti..., të cilët, ndryshe nga politika, te ne sikur kanë mbetur në plan të dytë.

Në Kosovë, ku imitimi është bërë kod i veprimit të atyre që vuajnë për famën që nuk e gëzojnë, ndodh shpesh që personat të cilët në shoqëri të tjera të avancuara do të konsideroheshin të padobishëm, ta gëzojnë statusin e VIP-it, pavarësisht asaj se pakkush këtu ka njohuri se cilat janë kriteret që e bëjnë një person të caktuar të

trajtohet si VIP, apo ndryshe nga qytetarët e zakonshëm.

Dhe, pa zbuluar detajet se kush konsiderohen në përgjithësi VIP-a, thonë se ata nuk janë vetëm nga politika, edhe pse shumica i takojnë këtij segmenti.

Një gjë dihet: Presidenti, kryeministri dhe kryetari i Parlamenti, siç dihet, përcillen me eskortë nga policia e Kosovës. Sidoqoftë, Kosova i ka VIP-at e saj jashtë politikës. E, cilët mund të jenë ata?



VETON SURROI, PUBLICIST

Deri para se xhamat e tij të jenë thyer me gurë, e që një gjë e tillë ndodhi që moti, njerëzit e kanë parë çdo ditë a mbrëmje publicistin Veton Surroi (dikur edhe kryetar i partisë "ORA"), duke shëtitur vetëm rrugëve të Prishtinës.

Por, kohët ndryshuan dhe një kohë të gjatë më Veton Surroi nuk ecte pa truproje. Sidoqoftë, një kohë të gjatë ka qëndruar nëpër botë, duke lobuar, siç thuhej për pavarësinë e Kosovës.

Me vetë faktin se shumë herë ka deklaruar se pasuria e tij arrin në 40 milionë euro e më shumë, kjo e bën të konsiderohet si VIP.

SINAN VLLASALIU, KËNGËTAR

Nëse kemi një VIP në muzikën kosovare, ai i takon Sinan Vllasaliut.

Por, me gjithë suksesin që ka arritur me këngët e tij, koncertet e albumet e shumta, shkuarje-ardhjet në Amerikë dhe kudo tjetër ku ka shqiptarë, Sinan Vllasaliu kurrë nuk është parë duke ecur me truproje e as nuk ka menaxher.

Punët i kryen vetë, ndërkohë që mbetet i pazëvendësueshëm në skenë.



AGNESA VUTHAJ, MIS

E sprovuar në konkursat e bukurisë dhe duke qenë edhe "Miss Kosova", Agnesa Vuthaj është person i rëndësishëm në skenën kosovare edhe me rezistencën e saj për ta dorëzuar kurorën e bukurisë pas pëshënjimeve dhe premtimeve të rrejshme që asaj i ishin bërë nga organizatorët dhe sponsorët e bukurisë, si fituese e veturës, meqë ishte shpallur "Miss Kosova". Megjithatë, Agnesa, një nga miset e rralla kosovare, që natyra veç bukurisë ia ka falur edhe mendjehollësinë, ishte person interesant edhe për faktin se një kohë që emëruar zëdhënëse e Nexhat Dacit, në garën e këtij të fundit për pushtet. Por, edhe ajo kohë kaloi dhe Agnesa iu kthye biznesit të vet, me të cilin edhe qëndron shumë mirë.

Agnesa, përndryshe, në jetën e përditshme është e thjeshtë, me të komunikohet lehtë, ndërsa bukuria ia ka mundësuar asaj të jetë në mesin e atyre që konsiderohen si VIP-a të jetës artistike në Kosovë.

Lum shkolla që e ka!

Nuk ia di emrin. Nuk ia di as mbiemrin. Nuk di as në cilën lagje të Prishtinës jeton. Di se punon në shkollën afër Redaksisë. Di se është shumë e thjeshtë, vishet bukur e me shije, ka sharm, ka stil. Pi kafe në kafenenë ku unë me tim koleg pi kafënë e mëngjesit, para se t'ia nisim punës në Redaksi. Kur ulet në tavolinën afër nesh me arsimtaret tjera, shpeshherë edhe më përshëndet, sepse është e edukuar, qytetare e vërtetë, ani pse s'e di as kush jam e ç'punë bëj, por më njeh ngase e shoh çdo ditë, veç të dielave. Gjithnjë, teksa pi kafe përballë saj, në mendje më vijnë lloj-lloj epitetesh: drenushë, pëllumbeshë, e veçantë, e paaritshme, e pashoqe, e pakrahasueshme... Por, që t'i shkruaj këta rreshta më lindi ideja teksa në një rën nga ditët e fundit të këtij viti shkollor e pashë teksa qëndronte në derë të shkollës, me shikimin larg, sikur priste t'i vinte dikush që ajo e dëshiron... Posa e pashë, i them tim shoku: "Lum

shkolla që e ka!". E ai, meqë e ka të njëjtën bindje për të, e ndoshta edhe më shumë, ma ktheu: "... edhe lum lagjja, mëhalla!".

Dhe, nëse "drenusha" i lexon këta pak rreshta, pa dyshim, do ta kuptoj se këta rreshta janë për të, se si ajo një tjetër nuk ka...

S. Rama

Radio,
Lajme, Moti,
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin
Shkabaj për Android

ANDROID APP ON
Google play



ALLURE BEAUTY JU KTHEN
20 VITE
pas në kohë!



Pa dhimbje! Pa kirurgji!
Allure Beauty

...edhe nga Bangladeshi!

Kosovarët ikin, të huajt vijnë të jetojnë në Kosovë!

Kosova çdo ditë e më shumë po zbrazet dhe vendet e punës po plotësohen me të rinj nga vende të ndryshme të botës, ndër të cilët sot për sot prijnë të rinjtë nga Bangladeshi.

Të rinjtë e këtij shteti po gjejnë në Kosovë punë me dhe pagat e këtushme, krahasuar me ato në shtetin e tyre, u mjaftojnë për jetë solide.

Kosova po zbrazet përditë e më shumë. Kemi qenë mbi dy milionë e kemi rënë në një milionë e gjysmë. Edhe sa do të zbres numri i popullatës në Kosovë nuk dihet, por ajo që dihet është se ditë e më pak po lindin fëmijë e ditë e më shumë po zbrazet Kosova.

Ç'THONË PUNËTORËT NGA BANGLADESHI QË PUNOJNË NË KOSOVË?

Më 29 qershor vizitua një grup të rinjsh nga Bangladeshi, të cilët kanë ardhur në Kosovë për punë.

Ata janë vendosur në një objekt hotelier të dikurshëm, në të cilin dikur ishte restoranti, kishite muzikë të mirë dhe pompa e benzinës.

Xhamat e ish-hotelit tash, në vend të perdeve, mbajnë çarçafë mbi dritareve dhe krejt çka shihet si lëvizje rreth tij janë njerëz nga një shtet i largët aziatik, Bangladeshi.

Udhëheqësi i tyre, Shahin Mia, është 35

vjeç. Ai me një grup të rinjsh punojnë për bukën e familjeve të tyre.

Ai i tha Revistës sonë, "Kosovarja", se jeta në Bangladesh është vështirë të sigurohet përmes punës atje dhe se Kosova është bërë atraktive për të rinjtë e atjeshëm.

Konkretisht, për revistën tonë, thotë:

"Jemi nga Bangladeshi. Është rrugë shumë e gjatë. Kalohet nëpër shumë sfida. Nisemi nga fshatrat tona në Bangladesh për në Dakar, e prej aty me aeroplan për në Katar, i cili ka relacionin Katar-Stamboll e nga Stambolli për në Prishtinë.

Jemi paraqitur në komunë që të marrim leje pune. Punën e bëjmë në "Euro Metal", firmë e komunës së Ferizajt dhe marrim nga 450 euro në muaj.

Me këto para jetojmë dhe mundohemi ndonjë ta ndajmë që t'ua dërgojmë familjes. Në shtëpi kam prindërit, gruan me djalë dhe vëllezër e një motër.

Len të përmendet se rroga mesatare te ne është nën 100 euro. E, po t'i fitoja nga 600 euro në muaj, në Bangladesh familja ime s'do të kishte pasur nevojë të punojë

për mbijetesë, sepse do ishte pagë për të jetuar mirë".

KOSOVA E BUKUR PËR TË RINJTË E BANGLADESHIT

Shahin Mia thotë se nuk mendon ta braktisë Kosovën.

"Unë kam ardhur të punoj në Kosovë dhe nuk mendoj ta lëshoj Kosovën, sepse është atraktive për ne", thotë ai dhe shton: "Kemi xhami afër dhe shkojmë për namaz. Na presin mirë, sepse e dinë se ne kemi ardhur për punë e jo për politikë.

Por, Kosova shërben si destinacion i mirë edhe për me dal jashtë, e ka të tillë që ia mësyjnë shteteve të Perëndimit.


Unë nuk e lë Kosovën, sepse ka punë dhe për punë kam ardhur", thotë Shahin Mia. Sidoqoftë, Kosova po zbrazet e vendi po popullohet me të rinj nga Bangladeshi dhe vende të tjera të botës.

Keq, a?!

Safet Krivaça

AUTO
ALBERTI



 /autosallonialberti

Kontakti: + 383 49 373 373
Email: autosallonialberti@hotmail.com

Bota është lodhur me ne!

Janë lodhur me ne! Bota po lëngon prej neve, shqiptarëve! Ka disa ditë që në Spanjë, Kuvendi i atjeshëm, e refuzoi kërkesën e një grupi katoloniaq që të njihet pavarësia e Kosovës...

Merreni me mend në çfarë pozite kemi rënë?! Nga populli i viktimizuar, e që na shpëtuan vendet mike, sot duhet t'i lusim të tjerë se a na pranojnë a jo...

Kështu, bota është lodhur me ne, duke ndërmjetësuar, madje jo vetëm me Serbinë!

E, si ilustrim po e përdori një batutë: Ishin zënë me fjalë dy shqiptarë në një barakë në Slloveni, që kishin shkuar të punonin, për të siguruar kafshatën e gojës. Me fjalë përleshshin për emrin e një vature dhe situata acarohet aq sa ndërhyjnë të tjerët që t'i ndajnë...

"Boll bre burrë se keni ardhur për bukë goje, e jo për luftë këtu! Po na bëni horë në mes të Sllovenisë!", i thotë njërit.

E, edhe tjetrit ia thotë po të njëjtat fjalë. Por, kur sheh se nuk po mund t'i pajtojë, u thotë: "More, copa u bëfshi! Kapni revolet e mbyteni njëri-tjetrin sa më shpejt!". Andaj, do të lodhen një ditë edhe të huajt me ne dhe do na e bëjnë si pajtuesi në Slloveni...

NË "MODË" ËSHTË ME I RRAHUR PRINDËRIT!

Ka ardhur një modë e re te brezi i ri. Lajme tronditëse lexojmë çdo ditë në gazeta e në portale: "Djali rrahu nënën!", "Djali rrahu babën dhe e bëri për spital!", "Nënë e vajzë

rrahin nusen!", "Nuse e burrë e rrahën nënën!" etj.

Pra, çka s'po ndodhë te ne! Andaj, edhe nuk është habi pse tokën e Kosovës e quajnë tokë të nemur, siç quhen edhe Bjeshkët e Nemuna.

Po, kush na paskësh nemur, ej? Vetëm ne të nemur, kurse të tjerët bëjnë jetë të lumtur?!

Ndoshta jemi të nemur, sepse nuk punojmë për shtetin, siç punojnë të tjerët për shtetin e tyre...

Ne nuk mundohemi të kemi një shtet të fuqishëm, sepse ëndërojmë të vjedhim sa më shumë...

B. Bajrami

TRAJTIMET ESTETIKE TË KOKËS DHE QAFES



Mbjellja e
Flokëve



Blepharoplasty



Facelift



Otoplasty



Rhinoplasty



Ngritje e
vetullave



Foxy Eyes



Chin
Liposuction



Chin Implant



Cheek Bones
Implant



Cantopexy



Lip Lift

Rr. Zef Jubani, Veternik - Prishtinë (Hyrja për në autostradë)

+383 (0) 45 707 744 | +383 (0) 43 707 744

Sa dashnorë i ka pasur gruaja ime?

Me Dilën kam kaluar më shumë se dy muaj. Ndoshta do të ishim bashkë për një kohë më të gjatë, pse jo edhe tërë jetën, sikur të mos ndodhte ajo që kurrë nuk e kisha pritur prej saj. Më kishte gënjyer kur kishte qenë e detyruar të flinte me një pronar të një firme për të mos e dëbuar nga puna...

Dilën nuk kam mundur ta paramendoj ndryshe, veç si një e përdalë. Për këtë arsye i kam thënë se nuk dëshiroj të vazhdoj më me të dhe që nga ajo ditë e kam parë përdore me mashkull tjetër. Kushedi edhe sa dashnorë të tjerë do t'i ketë ajo deri në ditën kur ndonjërin prej tyre do ta verbojë bukuria dhe dinakëria e saj, sepse, vërtet, Dila ishte shumë e bukur, por edhe tepër dinake.

Kurrë nuk i kisha simpatizuar femrat që kishin qenë shumë të bukura... Dhe, për këtë shkak ende nuk kisha rënë në dashuri me asnjë femër, e cila, në radhë të parë, ka qenë edhe simpatike, por edhe e sinqertë dhe zemërbujare. Nganjëherë më duhej të pranoja një fakt se është vështirë për një mashkull të martohet dhe të krijojë familje me një femër e cila para tij ka fjetur me kushedi sa meshkuj të tjerë. Kjo për shkakun se gjithë jetën do t'i rrijë në mendje e kaluara e gruas së tij dhe vazhdimisht do të dyshojë se ajo do i ripërtërijë lidhjet tanzare me ata edhe gjatë kohës martesore.

PSE FEMRAT NUK FLISNIN PËR TË KALUARËN E TYRE?

Mua më ka ndodhur që me shumicën e femrave, me të cilat kam dalë, jam njohur dhe jam dashuruar, që të gjitha t'më thonë se e kanë pasur vetëm një frajer. Por, te unë nuk prishte punë nëse vajza e cila më pëlqente jashtëzakonisht dhe, kuptohet, që më përshtatej të ketë

pasur një apo dy të dashur, me të cilët nuk u ka ecur. Shkurt dhe shqip: nuk më interesonte çfarë të shkuare ka pasur e dashura ime, vetëm më interesonte të di se ajo nuk ka qenë prostitutë dhe s'ka punuar në ndonjë shtëpi publike. Tjetër gjë është nëse ajo ka qenë e dashuruar në një person dhe ai e ka tradhtuar, e ka lënë... Vetëm dëshiroja t'më siguronte një femër se nesër-pasnesër, kur ajo të bëhej gruaja ime, të mos e shikojnë në rrugë si ndonjë nga ato vajzat që s'kanë lënë kujt pa u plotësuar dëshirat seksuale. Për këtë arsye ndodhesha në dilemë të madhe për të vendosur se kur duhet të martohem dhe me kë... E pranoj se kam pasur femra të bukura, ndonjëra prej tyre edhe sot e kësaj dite më simpatizon, por asnjëherë nuk më ka ndodhur që dikush nga të dashurat e mia t'ma thotë realitetin e jetës së tyre.

KUR U NGOPA ME AVENTURA, DOJA TË MARTOHESHA...

Kam ardhur në një përfundim shumë real se femrat gjithnjë trillojnë diçka, shpikën dhe mundohen të të shtinë në gjynah. Nuk mund t'i duroja kur thoshin se gabimisht janë dashuruar dhe kanë kuptuar më vonë se i dashuri i tyre ka qenë i martuar... Por, unë kam pasur një rregull të cilin gjithnjë e kam përdorur: kurrë nuk i pyesja femrat i sati dashnor i tyre isha, sepse e dija mirë se asnjëra prej tyre nuk e thotë të vërtetën. Si i ri vetja më dukej se jam njëfarë mashkulli, por, ç'është më e rëndësishmja, femër që dua nuk kisha. 30 vjet e kalova pa u martuar. E ndieja mungesën e dikujt, së cilës do i përkushtohesha me gjithë fuqinë e jetës sime. Me secilën femër që doja të njihesha me të, menjëherë dëshironte të martohet me mua ose i interesonte nëse kemi mundësi të iknim diku jashtë shtetit. Dhe, vetë fakti se ato donin aq shpejt të martoheshin me mua dhe të iknim jashtë, tregonte se e kaluara e tyre nuk ishte edhe aq e mirë. Unë, sinqerisht, isha i interesuar të gjeja një vajzë të bukur për martesë, por disa vajza me të cilat jam njohur pas daljeve tona të shpeshta

nuk u pritej dhe më thoshin shkurt: "Unë dua që sa më shpejt të fejojemi e martohemi, pa e zgjatur shumë muhabetin!".

VEÇ I KATËRTI A I PESTI ISHALLA JO...

Isha kategorikisht i vendosur se përpara se të lidhesha përnjëmend me një femër, ta njihja mirë, pavarësisht nëse kishte pasur më parë të dashur, që e kishte shfrytëzuar për një kohë dhe, pastaj, ia kishte kthyer shpinën. Por, në asnjë mënyrë nuk mund të martohesha me një vajzë, e cila te unë sheh dashnorin e saj të katërt a të pestë. "Nëse kërkon vajzë që ka pasur vetëm një frajer ose të tregon drejt se sa i ka pasur, do të mbetesh pa u martuar! Ku po jeton ti?", më pat thënë njëra nga to, e cila i kishte shkelur të 25-at dhe e cila nuk e dinte as vetë se sa meshkuj i kishte pasur.

KISHA FRIKË SE KUR TË MARTOHEM DO BËJNË ME GISHT KAH GRUAJA IME!




Po e përsëris edhe një herë se nuk më pengonte virgjëria e femrës, por më pengonte shumë nëse drejt saj bëjnë me gisht... Kjo kishte dallim të madh dhe ishte esenciale për mua. Me shumicën e femrave që dilja për t'u njohur (disa nga to edhe i kam çuar në shtrat me insistimin tim apo me vetëdëshirën e tyre), pothuajse si njëra ashtu edhe tjetra më pyetnin shkurt e shqip që në ditën e parë të njohjes: "A të pengon ty virgjëria e femrës, o djalë?". Përgjigja ime ishte e sinqertë: "Jo". Mirëpo, ajo "jo" kishte edhe një domethënie tjetër, sepse, edhe pse tash jam i martuar dhe i kam dy fëmijë, nuk më hiqet dot nga mendja se gruaja ime nuk ishte e virgjër, ani pse kur më pyeti se a të pengon që nuk jam e virgjër, aso kohe i pata thënë me plot gojën: "Jo". Dhe, ndodhi si ndodhi, u martuam dhe tash i kemi dy fëmijë si drita... Por, sidoqoftë, edhe pse vetë dikur i kisha thënë se s'më pengonte virgjëria e femrës, tash, si më çekan, më rri në mendje e kaluara e saj dhe nuk më lë rehat...

B. Bajrami



CIMA GRAND COMPLEX

PRISHTINA E RE

   www.cimaks.com



CIMA GRAND COMPLEX

PRISHTINA E RE

   www.cimaks.com

A ia kontrolloni partnerit telefonin celular?

Telefoni celular kudo në botë, e veçmas te ne shqiptarët, është mollë sherri i të dashuruarve. Shtrohet pyetja: A mund t'i ruajmë fshehtësitë që i përmban telefoni celular nga njerëzit kureshtarë që kemi përreth? Ka njerëz që me pa durim presin të zbulojnë ndonjë porosi që gjendet në telefonin tuaj. Më së shpeshti atë e bëjnë të dashuruarit. Andaj, ja se ç'thonë të anketuarit tanë për këtë...

Kur ia lexova mesazhin, zemra m'u ndal!



LULJA:

NUK DUA TELEFONIN T'MA KONTROLLOJ AS I DASHURI!

- Nëse dikush ma kontrollon telefonin tim, kjo gjë më pengon, madje shumë. Por, kjo varet edhe nga ajo se kush ma kontrollon telefonin. Bie fjala, nëse këtë gjë e bën i dashuri im, pa dyshim, ndihem keq, sepse ka raste kur e ruaj ndonjë mesazh marrë nga ndonjë shok a shoqe dhe mund të keqkuptohet. Megjithatë, e kam shprehur të keqe dhe shpesh të dashurit tim ia kontrolloj telefonin dhe m'u për këtë një ditë edhe patëm një zënkë bukur të madhe...



ASTRITI:

I TREGOJ GJITHÇKA TË DASHURËS SIME...

- Më pengon shumë kur kushdo qoftë ma kontrollon telefonin, e sidomos dashuria ime, e cila tash është në vitin e dytë të studimeve në psikologji. Kur ma kontrollon telefonin ndihem sikur nuk ka më besim në mua, sikur ka mësuar a dëgjuar për ndonjë thashetheme. E unë jam ai që i tregoj për gjithçka, sepse nuk jam prej atyre që merrin me dashuriçka. E kam gjetur një që e dua dhe më pëlqen, andaj edhe nuk dua të vrapoj pas të tjerave...



ERLETA:

IA KONTROLLOJ TELEFONIN SE E KAM ZËNË DUKE MË MASHTRUAR!

- Jam studente e juridikut, kurse i dashuri im punon në njërin nga ministratë tona. Një ditë, teksa pinim kafe bashkë, ai shkoi në tualet, e unë mbeta për pak çaste vetëm në tavolinën tonë. Mbi tavolinë ishte edhe telefoni i tij. Kur do Zoti për të keq, në ato çaste telefoni i tij cingëroi. Ishte një mesazh. U nervozova shumë, sepse nuk e dija nga kush i erdhi. Nuk e hapa. Kur erdhi e u ul, i thashë se pak më parë të erdhi një mesazh. E hapi, e lexoi dhe e mbylli telefonin sikur s'kishte asgjë me rëndësi në të, krejt i qetë. Kjo bëri që edhe unë të mos shqetësohesha. Por, teksa rrinim, dreqi më hipi në kokë dhe vend vetes nuk i zija. Kush do ia ketë dërguar? Ç'shkruan në atë mesazh? Nga kush? E të tjera pyetje më sillëshin në kokë. Nuk dija si ta gjeja mënyrën për t'ia marrë telefonin. Dhe, në çast sajova një gjë: I thashë se mu duk që aty pari kaloi djali i dajës së tij. Ai pa një e pa dy u ngrit dhe u nis drejt derës. Doli jashtë dhe, siç më duhej mua, u vonua pak. Shpejt e shpejt ia hapa telefonin dhe e lexova mesazhin të cilin nuk kishte arritur ta fshinte, meqë do e dinte se diçka fshihte prej meje. E, e keqja ishte se dikush kërkonte të pinin kafe bashkë. Nuk e kishte shkruar emrin në fund të mesazhit, por i thoshte se ti e di fort mirë se kush jam. U nevikosa, u bëra si e marrë... Kur u kthye nuk u përmbajta më dhe troç i thashë: Ta lexova mesazhin! Tash më thuaj se kush të ka shkruar? Ai u skuq në fytyrë dhe kjo bëri ta kuptoja se diçka fshihte prej meje. Dhe, që nga ajo kohë më nuk i besoj edhe atëherë kur i dashuri im m'i jep mesazhet që i ka në telefon t'ia lexoj. E kam humbur besimin në të. Por, e keqja është se e dua shumë, madje si e marrë dhe s'po kam kah t'ia mbaj...

PËRFUNDIMI

Ka kohë që telefonat celularë janë bërë pjesë e pandashme e jetës sonë, por edhe mjet që përçanë, që jep mundësi për grindje. Sidoqoftë, telefoni celular është mjet që na nevojitet në jetën e përditshme, por duhet ta dinë të gjithë se është edhe pjesë e privatësisë sonë. Andaj, për ata që nuk e dinë dhe që kanë dëshirë ta "fusin hundën" gjithkund, përfshirë këtu edhe në gjërat private të tjetërkujt, kjo do të jetë një porosi e qartë.

Diturie Haxhaja



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
veten



Detoksifikohu



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë

+383 45 224 540

Prizren

+383 43 900 902

Gjilan

+383 45 505 043

Gjakovë

+383 44 545 444

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Nuk jam e lumtur me asgjë!

Përshëndetje motër e dashur, jam 49-vjeçare, jetoj në rrethinën e Prishtinës, e kam një hall shumë të madh.

Burrin e kam 22 vjet më të moshuar se unë.

E kam marrë pas propozimit të familjes, meqë atij i kishte vdekur gruaja.

Nuk kam fëmijë të mi dhe, zakonisht, merrem me nipërit e burrit... Nëse i thonë kësaj jetë, nuk e di, por di se nuk jam e lumtur me asgjë...

Si e sheh të ardhmen time dhe çka të bëj tutje?

“E brengosura”

Përgjigje:

Shoh se burri yt nuk është mirë me shëndet dhe herë pas herë nuk është i aftë për punë nga disa ditë. Ka qenë shumë gabim që je përcaktuar për martesë me të, sepse e ardhmja jote nuk është e sigurt me të.

Ka mundësi që fëmija e tij të të dëbojnë nga shtëpia. Është vështirë që fëmija e një nëne tjetër ta durojnë një grua tjetër në shtëpi, e cila nuk lidhet asgjë me ata dhe nuk kanë asnjë arsye të jetojnë me gruan e babait.

Të sugjeroj të bësh kurorë sa më parë me burrë, sepse kështu, të paktën, nuk mbetesh në rrugë...

Do të ndahemi, apo?

Jam lexuese e rregullt e rubrikës tënde dhe të admiroj shumë për punën që bëni.

Të kam shkruar shumë herë dhe më je përgjigjur, për çka të falënderohem nga shpirti, sepse përgjigja juaj ka qenë udhërrëfim për mua.

Jam 44-vjeçare, doktoreshë, punoj qe shumë vitesh, por jam e pamartuar.

Para një viti fillova një lidhje me një person nga Tetova që jeton në Zvicër. Dukej se më donte, bisedonim gjatë dhe arsyeshëm dhe u takuam disa herë, për të filluar më në fund rregullimin e dokumenteve për atje.

Në këtë fazë filluan edhe problemet tona. Ai shprehte xhelozji, më akuzonte e më ofendonte, duke më etiketuar se e tradhtoja. Dhe, kjo mënyrë e sjelljes së tij vazhdoi për disa muaj, e para pak ditësh më tha se do të ndahet.

Ai po flet me halucinacione, me shenja psikopatie, pa ditur se unë kam rënë në krizë...

Si të sillem dhe çka të bëj?

“Zemra e thyer”

Përgjigje:

Jeni njohur me një person i cili nuk krahasohet me mentalitetin tënd intelektual dhe psikologjik.

Unë te ai nuk shoh shenja të psikopatisë e as të defekteve të tjera psikologjike, por shoh një qëllim të caktuar, i cili deshifrohet me gatishmërinë për ndarje.

Ai është sjellë mirë me ty deri në momentin kur i keni thënë t'ua rregulloj dokumentacionin që të shkoni te ai në Zvicër.

Andaj, meqë nuk është i gatshëm të martohet me ju, ka nisur ta imitojë të krisurin...

E, nëpërmjet sjelljes së keqe ka llogaritur të të bëjë të ftoftë ndaj tij dhe ta ndryshosh bindjen për të.

Sidoqoftë, sugjerimi im është të tërhiqesh, sepse nuk është njeriu i duhur për ty. Nuk keni të njëjtin rang intelektual e as profesional. Plus kësaj ti je në moshë kur nuk i duron gabimet e partnerit...

E, martesë nuk është vetëm dashuri, por, para së gjithash, interes jetësor.

Sepse, aty ku ka vetëm dashuri shpejt bie sistemi martesor.

A do të ndryshojë vjehrra e vajzës sime?

Jam nënë me një problem prej shumë vitesh. Vajza ime e do një djalë qe 7 a 8 vjet. Qe dy vjet është martuar, por nuk rri tërë kohën në shtëpinë e burrit, vetëm e vetëm shkaku i vjehrrës, se jo prej burrit, sepse jam e sigurt se ata e dashurojnë njëri-tjetrin.

A do të ndryshojë vjehrra e vajzës sime, së paku, shkaku i djalit të vet, sepse nuk kam parë e as dëgjuar për një nënë të tillë?

“Nëna e brengosur”

Përgjigje:

Aktualisht, pak vjehrra i duan rejat e tyre...

Ato luftojnë që shtëpia të ketë traditë dhe krenari dhe nusja të jetë e lavdëruar nga rrethi dhe masa. Kjo është dëshirë e vjehrrave, por

për nuset dhe nënat e nuseve nuk tingëllon kështu.

Nuk ka nënë që ia mendon të keqen djalit të vet, por nëse nusja e tepron, atëherë vlen fjala popullore "Për inati të resë më vdektë djali!"

Sidoqoftë, ju nuk e keni sqaruar nëse vajza jote ka bërë martesë me atë person që është dashur që sa vjet me të apo me ndonjë tjetër! E, nëse ajo e ka marrë dikë tjetër, kjo është e qartë se pas një dashurie të gjatë zor përshtatet në lidhjen e re.

Unë nuk shoh se vjehrra e vajzës tënde është armike e djalit të vet, por normale është se as nuk do të ketë komandant në shtëpi!

Sidoqoftë, nuk dua ta paragjykoj fajtorin, por ju, para së gjithash, duhet t'i vlerësoni gjërat ashtu sikur qëndrojnë dhe të keni dozë vetëkritike edhe për vajzën tuaj, sepse faji gjithnjë është jetim, por kurrë nuk është i njëanshëm.

A do të përmirësohet familja?

E nderuara magjistare, si familje jemi të bashkuar nga zori.

Djemtë i kemi të papërshtatshëm...

Ju lutem, a do të mësojë djali i vogël dhe a do të largohet nga shoqëria e keqe që e ka, sepse kohëve të fundit është agresiv deri në masën sa nuk po e njohim as ne vetë?!

A do të punësohem unë dhe kur?

A do ta shesim shtëpinë?

A do të bëjë më mirë nëna a është fundi i saj apo është më mirë ta dërgojmë në shtëpinë e pleqve?

Vëllait të vogël i kanë thënë se është keq me shëndet dhe dua të di a do të del nga kjo gjendje?

Kohëve të fundit kam depresion... Financiarisht jemi keq...

"E pashpresa"

Përgjigje:

Kur është keq, nesër pritet të jetë mirë.

Ju jeni pak më shumë se që duhet temperamente dhe pa durim për ta pritur ndryshimin.

Zoti i madhërishëm i rregullon të gjitha dhe ju duhet ta kuptoni më shumë djalin, për shembull, i cili e ka kohën e vet për të qenë pak më i lazdruar.

Unë e kuptoj se më mirë do të ishte sikur ai të mos ishte aty ku është, por me kohë i kalon të gjitha...

E, ajo që u jep agresivitet është mungesa financiare, e cila të rinjve u duhet më shumë dhe për çka nuk janë në gjendje t'i njohin prindërit dhe familjen kur nuk u plotësohen dëshirat, por një shumicë e të rinjve sot janë të tillë.

Me gjendjen që e keni sot mundohuni si familje të mos e shisni shtëpinë, sepse pa shtëpi nuk jetohet.

E, sa i përket punësimit tënd, shoh se je e ngarkuar mjaft shumë dhe mbingarkesa u jep pamje jo pozitive te punëdhënësit, prandaj merri gjërat pak më butësisht dhe më arsyeshëm, sepse koha është shumë shpesh shëruesi më i mirë i plagëve.

Ndërkaq, sa i përket nënës, nuk u kisha preferuar ta dërgoni në shtëpinë e pleqve, por të kujdeseni vetë aq sa mundeni e keni mundësi...

Pasditja më shkon me kokëdhembje!

Përsëndetje motër e nderuar, jam nënë e katër fëmijëve, jetoj në Prishtinë.

Kam jetë të mirë, por kështu nuk e kam pasur gjithnjë, sepse kam hequr dhe vuajtur në të kaluarën. Problemi im është se që nga vera që shkoi nuk jam gati asnjë ditë pa kokëdhembje. Kam qenë te

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

shumë mjekë dhe ata më thonë se është nga stresi e lodhja.

Analizat i kam mirë të gjitha, sepse rregullisht i kam bërë...

Çka më preferon?

A ka mundësi që e kam këtë problem nga të bëmat, sepse shumë gra më thonë se kjo mundet me qenë për shkak të magjive?

"Nëna e 4 fëmijëve"

Përgjigje:

Para së gjithash, duhesh llogaritur së problemin e kokëdhimbjes tënde e shkakton lodhja.

E lodhja nuk është prej sot, por është e vjetër, kronike.

Mirëpo, sa ka qenë trupi i fortë ka pasur imunitet dhe e ka kaluar

problemin, por në momentin që të ka rënë imuniteti problemi reflekton përmes kokëdhimbjes.

Normalisht, krejt kjo është nëse ti e ke tensionin mirë dhe nëse nuk pi duhan.

Kokëdhembja, zakonisht, mund të shfaqet pas dite edhe nëse nuk e bën natën gjumin mirë dhe nëse ke shqetësime.

Duhesh të marrësh vitamina "Kompleks B" dhe pashmangshëm edhe vitaminën C.

Kjo është e para që duhesh bërë nëse të tjerë faktorë janë në rregull te ti.

Nuk mund të them se e ke këtë problem nga magjia dhe jo gjithçka vjen prej magjisë.

Ato kanë tjetër çrregullim dhe reflektojnë probleme mendore. Ku ka magji njeriu ka probleme me mendjen.

E, ti nuk e ke këtë problem.

Çdo të premtë pasdite, katër vjet rresht, udhëtoja nga Prishtina për në Pejë, e kthehesha të dielën në mbrëmje, meqë të hënën në mëngjes më prisnin ligjëratat në Fakultetin e Shkencave Natyrore, në Degën e Kimisë.

Në fund të viteve 90, gjatë udhëtimit me tren nga Fushë-Kosova për në Pejë dhe anasjelltas për katër vjet rresh, kam përjetuar ndodhi e ndodhi, meqë edhe policia serbe shpesh na i kërkonte letërnjoftimet dhe arsyen pse udhëtonim...

S'ka erë më të këndshme se era e flokut të saj...

Por, këtë herë nuk do të merrem me policinë serbe, e cila herë-herë dinte edhe të na jepte ndonjë shufër gome në shpinë. Këtë herë po e qes në letër një kujtim të mirë, e që, edhe pse kanë kaluar vite e vite, nuk më hiqet dot nga mendja. Një femër engjëlllore, rreth të njëzetave, në korridorin e gjatë të vagonit vinte drejt meje. Në korridor kishte shumë udhëtarë, andaj edhe nuk kishte vende të lira për ulje. Kur u afrua afër meje, jam i vetëdijshëm se pa kurrfarë qëllimi, u kthye në krah për të kaluar afër meje. Por, floku i saj i dendur e i gjatë ma dha fytyrës "një shuplakë". "Më fal, të lutem!", ma ktheu ajo.

"Të falë me një kush: Përsërite edhe një herë!", më dolën fjalët sikur i kisha në maje të gjuhës. Ajo qeshi dhe vazhdoi ecjen, në kërkim të ndonjë vendi për ulje. Por, që nga ajo ditë, në mua mbeti një brengë - pse nuk ia lëshova vendin, që të njihesha me të... Dhe, një vit më vonë, po në të njëjtin relacion, ishte mu ajo... Por, këtë herë nuk e lashë t'më ikë... I bëra vend afër meje dhe i tregova se që një vit e mbaj në kujtesë flokun e saj kur m'u përplasë në fytyrë, erë që e barti me vete kudo që shkoj...

E. Zekaj, Pejë



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE